URDHËR
Nr. 328, datë 22.11.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE KËRKESAVE PËR CERTIFIKIMIN VETERINAR TË DISA LLOJE KAFSHËSH DHE MISHIT TË FRESKËT TË TYRE, TË CILAT HYJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA SHTETE TË CAKTUARA, SI DHE NGA TERRITORE TË TJERA NË ADMINISTRIM TË KËTYRE SHTETEVE"

(ndryshuar me urdhrin nr.223, datë 25.6.2012, nr. 125, datë 23.3.2018, nr. 18, datë 11.1.2019; nr. 91, datë 17.2.2021; nr. 237, datë 8.7.2022; nr. 231, datë 7.3.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 55 të ligjit nr.10 465 datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", nenit 18 të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Mbi përcaktimin e kritereve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa lloje kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera në administrim të këtyre shteteve".
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, drejtoritë rajonale të bujqësisë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
3. Ky urdhër hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

RREGULLORE

MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE KËRKESAVE PËR CERTIFIKIMIN VETERINAR TË DISA LLOJE KAFSHËSH DHE MISHIT TË FRESKËT TË TYRE, TË CILAT HYJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA SHTETE TË CAKTUARA, SI DHE NGA TERRITORE TË TJERA NË ADMINISTRIM TË KËTYRE SHTETEVE

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat e certifikimit veterinar për hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të ngarkesave të kafshëve të gjalla ose mishit të freskët, si më poshtë:
a) Kafshët thundrake;
b) Kafshët e listuara në pjesën 2 të aneksit IV bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
c) Mishin e freskët për konsum për njerëzit, duke përjashtuar produktet me bazë mishi të kafshëve thundrake dhe ekuideve.
2. Kjo rregullore përcakton listën e shteteve, territoreve ose pjesëve të tyre, prej të cilave mund të hyjnë në Republikën e Shqipërisë ngarkesat e përmendura në pikën 1.

3. Kjo rregullore nuk do të zbatohet për hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të kafshëve joshtëpiake (të egra):

a) për shfaqje ose ekspozita, ku këto kafshë nuk mbahen ose mbarështohen në mënyrë të rregullt;

b) që janë pjesë e cirqeve;

c) për qëllime shkencore ose eksperimentale, duke përfshirë institutet, organizatat apo qendrat e aprovuara për këto qëllime.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) "Ekuide" janë kafshë të egra ose të zbutura të llojeve të kuajve (përfshi dhe zebrat) ose të llojeve të gomarëve ose pasardhësit e kryqëzimeve të tyre;

b) "Fermë" është një fermë ose sipërmarrje tjetër bujqësore, industriale ose tregtare, që i nënshtrohet mbikëqyrjes veterinare zyrtare. Këtu përfshihen edhe kopshtet zoologjike, parqet e argëtimit dhe rezervatet e gjuetisë, në të cilat kafshët mbahen ose mbarështohen në mënyrë të rregullt.

c) "Kafshë thundrake" janë gjitarët e tokës që bëjnë pjesë në familjet Antilocapridae (antilopa amerikane), Bovidae (gjedhi, bualli, dhentë, dhitë, antilopat etj.), Camelidae (devetë, lamat etj.), Cervidae (dreri), Giraffidae (xhirafa), Hippopotamidae (hipopotami), Moschidae (lloj dreri), Suidae (derri, derri i egër), Tayassuidae (gjitarë të ngjashëm me derrin që gjenden në kontinentin amerikan), Tragulidae (gjitarë të ngjashëm me drerin, me trup të vogël që gjenden në Azinë Jugore dhe Juglindore), Rhinocerotidae (rinoqeronti), Tapiridae (tapiri), Elephantidae (elefanti);

d) "Mish i freskët" është mishi që nuk i është nënshtruar asnjë procesi ruajtjeje përveç ftohjes, ngrirjes ose ngrirjes së shpejtë, duke përfshirë mishin e paketuar në vakum ose që është paketuar në atmosferë të kontrolluar.

Neni 3

Kushtet e përgjithshme për futjen e thundrakëve në Republikën e Shqipërisë

Dërgesat e thundrakëve lejohen të hyjnë në Republikën e Shqipërisë nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) ato vijnë nga shtete, territore ose pjesë të tyre të listuara në kolonat 1, 2 dhe 3 të pjesës 1 të aneksit I, të cilës i përgjigjet një model i certifikatës veterinare për dërgesat e listuara në kolonën 4 të tabelës në pjesën 1 të aneksit I;

b) ato shoqërohen me certifikatën e duhur veterinare, të hartuar në përputhje me modelin e duhur të certifikatës veterinare të përcaktuar në pjesën 2 të aneksit I, duke marrë për bazë kushtet e veçanta të treguara në kolonën 6 të tabelës në pjesën 1 të atij aneksi, të plotësuara dhe nënshkruara nga një veteriner zyrtar i vendit eksportues;

c) ato përputhen me kërkesat e përcaktuara në certifikatën veterinare të përcaktuara në shkronjën "b"të këtij neni, përfshi:

i) garancitë shtesë të vendosura në atë certifikatë, siç jepen në kolonën 5 të tabelës në pjesën 1 të aneksit I;

ii) ndonjë kërkesë shtesë në certifikatën veterinare që mund të vendoset në përputhje me legjislacionin veterinar në fuqi dhe që përfshihen në certifikatë.

Neni 4

Kushtet për qendrat e grumbullimit për ngarkesa të caktuara të thundrakëve

Ngarkesat e thundrakëve që përmbajnë kafshë të gjalla nga më shumë se sa një fermë, lejohen të hyjnë në Republikën e Shqipërisë nëse ato janë grumbulluar në qendra grumbullimi të miratuara nga autoriteti kompetent i vendit të origjinës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pjesën 5 të aneksit I.

Neni 5

Protokollet për standardizimin e materialeve dhe procedurat e kampionimit dhe testimit për thundrakët

Kur, për certifikatat veterinare të listuara në kolonën 4 të pjesës 1 të aneksit I, kërkohet marrja e kampioneve dhe testimi për sëmundjet e listuara në pjesën 6 të atij aneksi, për futjen në Republikën e Shqipërisë të ngarkesave të kafshëve thundrake, kampionimi dhe testimi kryhet nga ose nën kontrollin e autoritetit kompetent të vendit eksportues/origjinës në përputhje me protokollet për standardizimin e materialeve dhe procedurave të testimit të përcaktuara në pjesën 6 të atij aneksi.

Neni 6

Kushtet e përgjithshme për lejimin e futjes në Republikën e Shqipërisë të disa llojeve të caktuara bletësh

1. Ngarkesat e bletëve që u përkasin llojeve të listuara në tabelën 1 të pjesës 2 të aneksit IV mund të futen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga shtete, territore ose pjesë të tyre, vetëm nëse:

a) ato janë të listuara sipas aneksit II, pjesa e 1-rë;

b) prania e Pestës Amerikane *(American foulbrood)*, aetinozës (*Aethina tumida*) dhe e parazitit Tropilaelaps (*Tropilaelaps spp.*) janë detyrimisht të lajmërueshme në të gjithë territorin e vendit eksportues ose territorin përkatës.

2. Në mënyrë përjashtimore nga pika 1 (a), ngarkesat e llojeve të bletëve lejohen të futen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një shtet, territor ose pjesë e tij që është e listuar në pjesën 1 të aneksit II që është:

a) një pjesë e izoluar gjeografikisht dhe epidemiologjikisht nga shteti ose territori;

b) e listuar në kolonën e tretë të tabelës në seksionin 1 të pjesës 1 të aneksit IV.

Në rastet kur zbatohet ky kufizim, futja e ngarkesave të bletëve duhet të ndalohet nga të gjitha shtetet, territoret ose pjesë të tyre, të cilat nuk janë të listuara në kolonën e tretë të tabelës në seksionin 1 të pjesës 1 të aneksit IV.

3. Ngarkesat e bletëve të llojeve të listuara në tabelën 1 të pjesës 2 të aneksit IV përbëhen nga:

a) kafaze të mëmave të bletëve ose bombusesh (*Apis mellifera* dhe *Bombus spp.*), ku secili përmban një mëmë të vetme me një minimum prej 20 shoqëruesesh; ose

b) kontejnerë bombusesh (*Bombus spp.*), ku secili përmban një koloni me një maksimum prej 200 bombusesh të rritur.

4. Ngarkesat e bletëve të llojeve të listuara në tabelën 1 të pjesës 2 të aneksit IV duhet:

a) të shoqërohen nga një certifikatë veterinare, e hartuar në përputhje me modelin përkatës së certifikatës veterinare, siç është përcaktuar në pjesën 2 të aneksit IV, e plotësuar dhe e nënshkruar nga një inspektor veterinar zyrtar i vendit eksportues;

b) të jenë në përputhje me kërkesat veterinare të vendosura në certifikatën veterinare të

përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike.

Neni 7

Kushtet e përgjithshme për transportin e kafshëve të gjalla për në Republikën e Shqipërisë

Gjatë periudhës pas ngarkimit në vendin eksportues të origjinës dhe përpara mbërritjes në pikën e inspektimit kufitar të hyrjes në Republikën e Shqipërisë, ngarkesat e kafshëve të gjalla nuk duhet:

a) të transportohen së bashku me kafshë të gjalla që:

i) nuk janë përcaktuar për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ose

ii) kanë një gjendje më të ulët shëndetësore;

b) të shkarkohen, ose të transferohen në një avion tjetër kur transportohen nëpërmjet ajrit, ose të lëvizen me mjete të transportit rrugor apo hekurudhor, ose të lëvizin në këmbë përmes një shteti tjetër, territor ose pjesë e tij që nuk është e listuar në kolonat 1, 2 dhe 3 të tabelës së përcaktuar në pjesën 1 të aneksit I, ose kur ngarkesa nuk shoqërohet me modelin e certifikatës veterinare të listuar në kolonën 4 të tabelës në pjesën 1 të aneksit I.

Neni 8

Afatet për periudhën e transportit për në Republikën e Shqipërisë të kafshëve të gjalla

Ngarkesat e kafshëve të gjalla lejohen të futen në Republikën e Shqipërisë kur ato mbërrijnë, brenda 10 ditëve nga data e lëshimit të certifikatës së duhur veterinare në pikën e inspektimit kufitar të hyrjes.

Në rastin e transportit detar afati 10-ditor i kërkuar zgjatet për një periudhë shtesë nëpërmjet një deklarate të nënshkruar nga kapiteni i anijes. Kjo periudhë zgjatet në përputhje me kohëzgjatjen e udhëtimit dhe kopja origjinale e kësaj deklarate, e hartuar në përputhje me pjesën 3 të aneksit I, i bashkëngjitet certifikatës veterinare që shoqëron ngarkesën.

Neni 9

Kushtet e veçanta në lidhje me spërkatjen me një insekticid të përshtatshëm të ngarkesave të kafshëve të gjalla të transportuara me anë të ajrit për në Republikën e Shqipërisë

Në rastin e ngarkesave të kafshëve të gjalla që transportohen me anë të ajrit, me përjashtim të ngarkesave të bletëve, kontejnerët ose arkat me të cilat transportohen kafshët dhe zona përreth spërkaten me një insekticid të përshtatshëm.

Spërkatja kryhet menjëherë pas ngarkimit dhe përpara mbylljes së dyerve të avionit, si dhe pas çdo hapje tjetër të derës në një vend tjetër transit, deri sa avioni të mbërrijë në vendin e caktuar.

Komandanti i avionit vërteton kryerjen e spërkatjes me anë të një deklarate të nënshkruar, hartuar në përputhje me pjesën 4 të aneksit I, kopja origjinale e së cilës i bashkëngjitet certifikatës veterinare.

Neni 10

Kushtet që zbatohen pas hyrjes në Republikën e Shqipërisë të ngarkesave të disa thundrakëve

1. Pas hyrjes në Republikën e Shqipërisë, ngarkesat e kafshëve thundrake për mbarështim dhe prodhim ose për kopshtet zoologjike, parqet ku mbahen kafshë të egra ose rezervatet e

gjuetisë, transportohen pa vonesë për në fermën ose vendin pritës.

Kafshët thundrake mbahen në atë fermë ose vend për të paktën 30 ditë, me përjashtim të rasteve kur dërgohen drejtpërsëdrejti për në një thertore.

2. Pas hyrjes në Republikën e Shqipërisë, ngarkesat e kafshëve thundrake për therje të menjëhershme transportohen pa vonesë për në thertoren e përcaktuar, ku do të theren brenda 5 ditëve pune nga data e mbërritjes.

Neni 11

Kushtet e veçanta në lidhje me transitimin përmes shteteve, territoreve ose pjesëve të tyre të disa ngarkesave të thundrakëve

Në rastin kur zbatohen kushtet e veçanta të pjesës 1 të aneksit I, me qëllim lejimin e transitimit të ngarkesave të thundrakëve të përcaktuara në këto kushte, nga vendi i origjinës, përmes një vendi, territori ose pjese të tij, që është listuar në tabelën në pjesën 1 të aneksit I, por për të cilin nuk ka një model certifikate veterinare që përshtatet me ngarkesën e thundrakëve në fjalë, të dhënë në kolonën 4 të asaj tabele, zbatohen kushtet e mëposhtme:

a) për gjedhin e majmërisë (prodhim mishi):

i) fermat e mbërritjes janë përcaktuar paraprakisht nga autoriteti kompetent i vendit pritës;

ii) kafshët e gjalla që përbëjnë ngarkesën nuk lejohet të lëvizen nga ferma pritëse përveç se për therje të menjëhershme;

iii) të gjitha lëvizjet e kafshëve të gjalla për në fermë dhe prej fermës kryhen nën kontrollin e shërbimit veterinar rajonal për aq kohë sa kafshët që përbëjnë ngarkesën mbahen në fermë.

b) për thundrakët për therje të menjëhershme, zbatohet neni 10 pika 2.

Neni 12

Kushtet që duhen zbatuar pas hyrjes në Republikën e Shqipërisë të ngarkesave të bletëve

1. Ngarkesat e mbretëreshave të bletëve të përmendura në nenin 6 (3) (a) transportohen pa vonesë në vendin e mbërritjes ku zgjojet vendosen nën kontrollin e shërbimit veterinar rajonal dhe mbretëreshat e bletëve transferohen në kafaze të reja përpara se të futen në kolonitë vendase.

2. Kafazet, bletët shoqëruese, dhe materiale të tjera që shoqërojnë mbretëreshat e bletëve nga vendi i origjinës dërgohen në laboratorin e përcaktuar nga autoriteti kompetent veterinar për t'u ekzaminuar për praninë e:

a) parazitit *Aethina tumida*, vezët ose larvat e tij;

b) shenjave të parazitit Tropilaelaps (*Tropilaelaps* spp.).

Kafazet, bletët shoqëruese dhe materialet shkatërrohen pas ekzaminimit në laborator.

3. Ngarkesat e bombuseve (*Bombus spp.*) të përmendura në nenin 6 (3) (b) transportohen pa vonesë në vendin e mbërritjes.

Bombuset mund të qëndrojnë në kafazin me të cilin kanë hyrë në Republikën e Shqipërisë deri në fund të ciklit jetësor të kolonisë.

Kafazi dhe materialet shoqëruese të bombuseve nga vendi i origjinës shkatërrohen menjëherë pas përfundimit të ciklit jetësor të kolonisë.

Neni 13

Kushtet e përgjithshme për importin e mishit të freskët

Ngarkesat e mishit të freskët për konsum nga njerëzit importohen në Republikën e Shqipërisë nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) ato vijnë nga vende të Bashkimit Europian;

b) ato vijnë nga vende, territore ose pjesë të tyre të listuara në kolonat 1, 2 dhe 3 të tabelës 1 të aneksit II, për të cilën ka një model të certifikatës veterinare që përputhet me ngarkesën në fjalë të listuar në kolonën 4 të pjesës 1 të aneksit II;

c) ato paraqiten në pikën e inspektimit kufitar të hyrjes në Republikën e Shqipërisë të shoqëruara me certifikatën e duhur veterinare, hartuar në përputhje me modelin përkatës të certifikatës veterinare të përcaktuar në pjesën 2 të aneksit II, duke marrë parasysh kushtet e veçanta të dhëna në kolonën 6 të tabelës në pjesën 1 të atij aneksi, dhe të plotësuara dhe nënshkruara nga veterineri zyrtar i vendit eksportues;

d) ato përputhen me kërkesat e përcaktuara në certifikatën veterinare të përmendur në pikën (c), përfshi dhe:

i) garancitë shtesë të vendosura në atë certifikatë, kur jepen në kolonën 5 të tabelës në pjesën 1 të aneksit II;

ii) çdo kërkesë shtesë të certifikimit veterinar që Republika e Shqipërisë mund të vendosë në përputhje me legjislacionin veterinar dhe që janë të përfshira në certifikatë.

Neni 14

Kushtet që duhen zbatuar pas importit të karkasave pa lëkurë të kafshëve të egra dythundrake

Ngarkesat e karkasave pa lëkurë të kafshëve të egra dythundrake për konsum nga njerëzit transportohen pa vonesë për në stabilimentin përpunues të mbërritjes.

Neni 15

Transiti dhe magazinimi i mishit të freskët

Hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë e ngarkesave të mishit të freskët, me qëllim transitim të menjëhershëm, ose transitimin pas magazinimit, bëhet kur ato plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) ngarkesat vijnë nga ato shtete që janë përfshirë në listën që shteti i destinacionit të ngarkesës, ka miratuar si listë të shteteve prej ku lejohet importi;

b) ato plotësojnë kërkesat e veçanta të shëndetit të kafshëve për ngarkesat në fjalë, siç është parashikuar në modelin përkatës të certifikatës veterinare në përdorim nga shteti i destinacionit;

c) pranimi i tyre për transit ose dhe magazinim vërtetohet nga dokumenti veterinar për import dhe transit i hyrjes (DVIT) të nënshkruar nga veterineri zyrtar i pikës së inspektimit kufitar të hyrjes në Republikën e Shqipërisë.

Neni 16

Certifikimi

1. Certifikatat veterinare të përcaktuara në këtë rregullore plotësohen në përputhje me shënimet shpjeguese të përcaktuara në aneksin V.

2. Certifikata veterinare mund të paraqiten edhe në formën e certifikimit elektronik ose të ndonjë forme tjetër të rënë dakord me shtete të veçanta dhe duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në aneksin V.

Neni 17
Përditësimi i listave

Ministri, me propozimin e Drejtorisë së Shëndetit të Kafshëve, miraton listat e përditësuara të vendeve dhe territoreve të përfshira në anekset e kësaj rregulloreje. Listat përditësohen të paktën një herë në vit.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ANEKSI I
THUNDRAKËT

PJESA 1
(Ndryshuar pika 2 me urdhrin nr. 237, datë 8.7.2022)

1. Vendet e Bashkimit Europian

Mund të importohen kafshë të gjalla nga të gjitha ato vende që në çastin e importit janë anëtare të Bashkimit Europian, kur ato shoqërohen nga modeli i certifikatës veterinare "BOV-X", "BOV-Y", "OVI-X", "OVI-Y", "POR-X", "POR-Y", "RUM" dhe "SUI".

2. Lista e vendeve jashtë Bashkimit Europian, territoreve ose pjesëve të tyre (*)

Shteti	**Kodi i territorit**	**Përshkrimi i territorit**	**Certifikata veterinare**		**Kushte të veçanta**
			Modeli	GSH	
1	2	3	4	5	6
MK – Maqedonia e Veriut	MK-0	I gjithë vendi	BOV-X , BOV-Y, OVI-X, OVI-Y, POR-X, POR-Y, RUM, SUI.		
RS – Serbi	RS-0	I gjithë vendi	BOV-X, BOV-Y, OVI-X, OVI-Y, POR-X, POR-Y, RUM, SUI.		

PJESA 2
MODELET E CERTIFIKATAVE VETERINARE

Modelet:

BOV-X: Model i certifikatës veterinare për gjedhin (përfshi dhe llojet *Bubalus* dhe *Bison,* si dhe kryqëzimet e racave të tyre) me qëllim për mbarështim dhe/ose prodhim pas importit.

BOV-Y: Model i certifikatës veterinare për gjedhin (përfshi dhe llojet *Bubalus* dhe *Bison,* si dhe kryqëzimet e racave të tyre) me qëllim për therje të menjëhershme pas importit.

OVI-X: Model i certifikatës veterinare për dhentë (*Ovis aries*) dhe dhitë (*Capra hircus*) me qëllim për mbarështim dhe/ose prodhim pas importit.

OVI-Y: Model i certifikatës veterinare për dhentë (*Ovis aries*) dhe dhitë (*Capra hircus*) me qëllim për therje të menjëhershme pas importit.

POR-X: Model i certifikatës veterinare për derrat shtëpiakë (*Sus scrofa*) me qëllim për mbarështim dhe/ose prodhim pas importit.

POR-Y: Model i certifikatës veterinare për derrat shtëpiakë (*Sus scrofa*) me qëllim për therje të menjëhershme pas importit.

RUM: Model i certifikatës veterinare për kafshët e rendit *Artiodactyla* (me përjashtim të gjedhit përfshi dhe llojet Bubalus dhe Bison dhe kryqëzimet e racave të tyre, dhenve - *Ovis aries*, dhive - *Capra hircus*, *Suidae* dhe *Tayassuidae*) dhe të familjeve *Rhinocerotidae* dhe *Elephantidae*.

SUI: Model i certifikatës veterinare për kafshët joshtëpiake të familjes *Suidae*, kafshët e familjeve *Tayassuidae* dhe *Tapiridae*.

GSH (Garancitë shtesë):

A: Garanci në lidhje me testet për sëmundjen e "Gjuhës blu" dhe të sëmundjes "Epizootike-hemorragjike" në kafshët e certifikuara në përputhje me modelin e certifikatës BOV-X (pika II.2.8 B), OVI-X (pika II.2.6 D) dhe RUM (pika II.2.6).

B: Garanci në lidhje me testet për sëmundjen vezikulare të derrit dhe të murtajës klasike të derrit të certifikuara në përputhje me modelin e certifikatës POR-X (pika II.2.4 B) dhe SUI (pika II.2.4 B).

C: Garanci në lidhje me testet e brucelozës në kafshët e certifikuara në përputhje me modelin e certifikatës POR-X (pika II.2.4 C) dhe SUI (pika II.2.4 C).

Modeli BOV-X

Certifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë të kafshëve të llojit gjedh për mbarështim dhe/ose prodhim

Modeli BOV-Y

Certifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë të kafshëve të llojit gjedh për therje të menjëhershme pas importit

Modeli OVI-X

Certifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi për mbarështim dhe/ose prodhim

Modeli OVI-Y

Certifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi për therje të menjëhershme pas importit

Modeli POR-X

Certifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë të kafshëve të llojit derra shtëpiakë për mbarështim dhe/ose prodhim

Modeli POR-Y

Certifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë të kafshëve të llojit derra shtëpiakë për therje të menjëhershme pas importit

Modeli RUM

Certifikata shëndetësore për kafshët e rendit Artiodactyla dhe të familjeve Rhinocerotidae dhe Elephantidae

Modeli SUI

Certifikata shëndetësore për kafshët joshtëpiake të familjes Suidae, kafshët e familjeve Tayassuidae dhe Tapiridae

(ndryshuar modeli BOV-X dhe BOV-Y I certifikatave, me urdhërin nr. 91, datë 17.2.2021; ndryshuar modelet e certifikatave BOV-X, BOV-Y, OVI-X, OVI-Y, POR-X, POR-Y dhe SUI me urdhrin nr. 231, datë 7.3.2025)

Certifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë të kafshëve të llojit gjedh për mbarështim dhe/ose prodhim

Health veterinary certificate for import of bovine animals for breeding and production

Modeli BOV-X /Model BOV-X /

Part I : Details of consignment / Pjesa I : Detajet e dërgesës

I.1. Consignor/Exporter Dërguesi/Eksportuesi **Name** Emri **Address** Adresa **Country** Shteti **ISO country code** Kodi i shtetit	**I.2. Certificate reference number** Numri i referencës së Certifikatës **I.3.Central Competent Authority** Autoriteti Kompetent Qëndror **I.4. Local Competent Authority** Autoriteti Kompetent Lokal	**I.2a. IMSOC reference** Referenca IMSOC **QR CODE** KODI QR
I.5. Consignee/Importer Marrësi/Importuesi **Name** Emri **Address** Adresa **Country** Shteti **ISO country code** Kodi ISO i shtetit	**1.6 Operator responsible for the consignment** Operatori përgjegjës për ngarkesën **Name** Emri **Address** Adresa **Country** Shteti **ISO country code** Kodi ISO i shtetit	
1.7.Country of origin/ Shteti i origjinës **ISOcode /**kodi ISO	**I.9. Country of destination/** Shteti i destinacionit **ISO code** Kodi ISO	
I.8. Region of origin/ Rajoni i origjinës **Code** Kodi	**I.10. Region of destination** Rajoni i destinacionit **Code** Kodi	
I.11. Place of origin/ Vendi i origjinës **Name** Emri **Approval number** Numri i Aprovimit **Address** Adresa **ISO country code** Kodi ISO i shtetit **Country** Shteti	**I.12. Place of destination** Vendi i destinacionit **Name** Emri **Registration/Approval No/** Nr. aprovimit/regjistrimit **Adress** Adresa **Country** Shteti **ISO country code** Kodi i shtetit	
I.13 Place of loading Vendi i ngarkesës	**I.14. Date and time of departure** Data dhe ora e nisjes	
I.15. Means of transport/ Mjeti i transportit ☐ **Aircraft /** Avion/ ☐ **Vessel /** Anije/ ☐ **Railway /** Hekurudhë/ ☐ **Road vehicle /** Mjet rrugor/ **Identification :** Identifikimi	**I.16. Entry Border Control Post** Pika Kontrollit në Pikën Kufitare **I.17. Accompanying documents/** Dokumentet shoqëruese **Type** Lloji **Code** Kodi **Country** Shteti **ISO country code** Kodi ISO i shtetit **Commercial document reference** Referenca e dokumentit tregtar	

I.18 Transport conditions/ Kushtet e transportit	☐ **Ambient** Ambienti	☐ **Chilled** I ftohur	☐ **Frozen** I ngrirë

I.19 Container number/Seal number Numri i kontejnerit/Numri i vulës/ **Container No/** Nr. Kontejnerit/ **Seal No/** Nr. Vulës/
I.20 Certified as or for/ Certifikuar si ose për
☐ **Further keeping** Mbajtje të mëtejshme ☐ **Quarantine establishment** Karantinë ☐ **Exhibition** Ekspozitë ☐ **Travelling circus/animal acts** Cirku udhëtues/ Kafshë cirku

I.21 ☐ **For transit/** Për tranzit **Third country/** Vendi i tretë — **ISO country code** Kodi ISO i shtetit	I.22 ☐ **For internal market/** Për tregun e brendshëm I.23
I.24	I.25 **Total quantity/** Sasia totale — I.26

I.27 **Description of consignment/** Përshkrimi i dërgesës

CN code Kodi CN	Species Specia	Subspecies/Category Nënspecie/Kategori	Sex Gjinia	Identification system Sistemi identifikimit	Identification number Numri i identifikimit	Age Mosha	Quantity Sasia

II. **Health information** Informacion shëndetësor	**II.a. Certificate reference number** Certifikatë me numër reference	II.b.

II.1. Public Health attestation [*to delete when the Republic of Albania is not the final destination of the animals]
Vërtetim për shëndetin publik [*të fshihet kur Republika e Shqipërisë nuk është destinacioni përfundimtar i kafshëve]

I, the undersigned official veterinarian, hereby certify, that the animals described in Part I:
Unë i nënshkruari Veterineri Zyrtar, certifikoj që kafshet e përshkruara në Pjesën I:

II.1.1. have not received:
Nuk kanë marrë:

- **any stilbene or thyrostatic substances,**
  Ndonjë stilbene apo substanca tireostatike,

- **oestrogenic, androgenic, gestagenic or beta-agonist substances for purposes other than therapeutic or zootechnical treatment (as defined in Council Directive 96/22/EC);**
  Estrogjene, androgjene, gestagjene ose substanca β-agoniste për qëllime të ndryshme nga ato terapeutike apo trajtime zooteknike (përcaktuar në Direktiven e Keshillit 96/22/EC)

II.1.2. fulfil the guarantees provided by the control plans submitted in accordance with Article 6(2) of Commission Delegated Regulation (EU) 2022/2292, and the concerned animals are listed in Annex -I to Commission Implementing Regulation (EU) 2021/405 for the concerned third country or territory of origin;/ përmbushin garancitë e dhëna nga planet e kontrollit, të paraqitura në përputhje me nenin 6(2) të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/2292, dhe kafshët në fjalë janë renditur në Aneksin -I të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2021/405 për vendin ose territorin e origjinës në fjalë;

II.1.3. with regard to bovine spongiform encephalopathy (BSE):
Përsa i përket encephalopatise spongiforme të gjedhit (BSE):

(a) the animals are identified by a permanent identification system enabling them to be traced back to the dam and herd of origin, and they are not:
kafshët identifikohen nga një sistem identifikimi i përhershëm që mundëson gjurmimin e tyre që nga lindja dhe tufën e origjinës, dhe ato nuk janë:

(i) BSE cases
Rastet e BSE-së

(ii) bovine animals which, during their first year of life, were reared with BSE cases during their first year of life, and which investigation has shown that they have consumed the same potentially contaminated feed during that period; or
kafshët e llojit gjedh të cilët, gjatë vitit të parë të jetës janë rritur në prani të rasteve të BSE-së dhe në të cilët hetimet tregojnë që kanë konsumuar të njëjtin ushqim potencialisht të kontaminuar gjatë asaj periudhe; ose

(iii) if the result of the investigation referred to the point (ii) are inconclusive, bovine animals which, during their first year of life, were reared with BSE cases during their first year of life, were born in the same herd as, and within 12 months preceding or following the date of the birth of, the BSE cases;
nëse rezultati i hetimit të përmendur në pikën (ii) është pa rezultate, kafshët gjedh të cilat, gjatë vitit të tyre të parë të jetës, janë rritur me raste të BSE-së gjatë vitit të parë të jetës, ose kanë lindur në të njëjtën tufë si, dhe brenda 12 muajve para ose pas datës së lindjes së rasteve të BSE-së;

(1) **either** / ose **[(b)**

(i) the animals were born and continuously reared in country or region or countries or regions classified in accordance with Commission Decision 2007/453/EC as countries or regions posing a negligible BSE risk;
kafshët kanë lindur dhe janë rritur vazhdimisht në vend ose rajon ose vende ose rajone të klasifikuara në përputhje me Vendimin e Komisionit 2007/453/EC si vende ose rajone që paraqesin një rrezik të papërfillshëm të BSE-së;

(ii) if there have been BSE indigenous cases in the country or region thereof concerned, the animals were born after the date from which the ban on the feeding of ruminants with meat-an-bone meal and greaves derived from ruminants as defined in the Terrestrial Animal Health Code of the World Organisation for Animal Health, was effectively enforced or after the date of birth of the last BSE indigenous cases if born after the date of the feed ban.]
[Në qoftë se ka pasur raste indigjene me BSE në vendin ose rajonin në fjalë, kafshët kanë lindur pas datës nga e cila ndalimi i të ushqyerit të ruminanteve me miell mishi-kockash dhe dhjami që rrjedhin nga ruminantet siç përcaktohet në Kodin e Shëndetit të Kafshëve Tokësore të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve është aplikuar efektivisht, ose pas datës së lindjes nga rastet e fundit indigjene me BSE, në rastet kur ato kane lindur pas datës së ndalimit të ushqyerit.]

(1) **or**/ ose **[(b)**

(i) the country or region thereof of origin of the animals in classfied in accordance with Decision 2007/453/EC as a country or region posing a controlled BSE risk;
kafshët kanë lindur dhe janë rritur vazhdimisht në vendin ose rajon ose vende ose rajone të klasifikuara në përputhje me Vendimin e Komisionit 2007/453/EC si vende ose rajone që paraqesin një rrezik të papërfillshëm me BSE;

(ii) the animals were born after the date from which the ban on the feeding of ruminants with meat-an-bone meal and greaves derived from ruminants as defined in the Terrestrial Animal Health Code of the World Organisation for Animal Health, was effectively enforced, or they were born after the date of birth of the last BSE indigenous cases if born after the date of the feed ban.]
[kafshët që kanë lindur pas datës nga e cila ndalimi i të ushqyerit të ruminanteve me miell mishi-kockash dhe dhjami që rrjedhin nga ruminantet siç përcaktohet në Kodin e Shëndetit të Kafshëve Tokësore të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve është aplikuar efektivisht, ose kanë lindur nga rastet e fundit indigjene me BSE në rastet kur ato kanë lindur pas datës së ndalimit e të ushqyerit]

([1]) **or** / ose **[(b)**

(i) the country or region of origin of the animals in classfied in accordance with Decision 2007/453/EC as a country or region posing an undetermined BSE risk;
vendin ose rajonin e origjinës së kafshëve të klasifikuara në përputhje me Vendimin 2007/453/EC si vende ose rajone që paraqesin një rrezik të papërcaktuar me BSE;

(ii) the feeding of ruminants with meat-and-bone meal and greaves from ruminants, as defined in the Terrestial Animal Health Code of the World Organisation for Animal Health, has been banned and the ban has been effectively enforced in the country or region of origin;
(ii) ushqyerja e ripërtypësve me miell mishi dhe miell kockash dhe dhjami nga ripërtypësit, siç përcaktohet në Kodin e Shëndetit të Kafshëve Tokësore të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve, është ndaluar dhe ndalimi është zbatuar efektivisht në vend ose rajonin e origjinës;

(iii) the animals were born at least two years after the date from which the ban on the feeding of ruminants with meat-an-bone meal and greaves derived from ruminants, as defined in the Terrestrial Animal Health Code of the World Organisation for Animal Health, was effectively enforced, or they were born after the date of birth of the last BSE indigenous cases if born after the date of the feed ban.]
[kafshët që kanë lindur ne dy vitet e fundit pas datës nga e cila ndalimi i të ushqyerit të ruminanteve me miell mishi dhe miell kockash dhe dhjami që rrjedhin nga ruminantet siç përcaktohet në Kodin e Shëndetit të Kafshëve Tokësore të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve është aplikuar efektivisht, ose pas datës së lindjes nga rastet e fundit indigjene me BSE në rastet kur ato kanë lindur pas datës së ndalimit e të ushqyerit.]

(1)[(1),(15)] 11.1.a. Attestation as regards Commission Delegated Regulation (EU) 2023/905 [Delete when the Union is not the final destination of the animals]/ Vërtetim në lidhje me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2023/905 [Fshije kur Bashkimi Evropian nuk është destinacioni përfundimtar i kafshëve]/

I, the undersigned official veterinarian, hereby certify that the animals described in Part I have not been administered antimicrobial medicinal products for growth promotion or yield increase or antimicrobial medicinal products containing an antimicrobial that is included in the list of antimicrobials reserved for the treatment of certain infections in humans laid down in Commission Implementing Regulation (EU) 2022/1255, as set out in Article 3 of Commission Delegated Regulation (EU) 2023/905 and originate from a third country or region thereof listed in accordance with Article 5(2) of Delegated Regulation (EU) 2023/905./ Unë, veterineri zyrtar i nënshkruar, vërtetoj se kafshët e përshkruara në Pjesën I nuk u janë dhënë produkte mjeksore antimikrobike për nxitjen e rritjes ose rritjen e rendimentit ose produkte mjeksore antimikrobike që përmbajnë një antimikrobik që përfshihet në listën e antimikrobikëve të rezervuar për trajtimin e disa infeksioneve tek njerëzit, të përcaktuar në Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2022/1255, siç përcaktohet në nenin 3 të Rregullores së deleguar të Komisionit (BE) 2023/905 dhe kanë origjinën nga një vend ose rajon i tretë i tij, i listuar në përputhje me nenin 5(2) i Rregullores së Deleguar (BE) 2023/905.

II.2. Animal Health attestation:
Vërtetim për shëndetin e kafshëve

I, the undersigned official veterinarian, hereby certify, that the animals described in Part I:
Unë, veterineri zyrtar i nënshkruar, vërtetoj se kafshët e përshkruara në Pjesën I:

II.2.1. come from the zone with code: - [(2)] which, at the date of issueof this animal health/official certificate is authorised from entry into the Republic of Albania of bovine animals and listed in Part 1 of Annex II to Commission Implementing Regulation (EU) 2021/404:
II.2.1. vijnë nga zona me kodin: (2) e cila, në datën e lëshimit të kësaj certifikate është e autorizuar nga hyrja në Republikën e Shqipërisë e kafshëve të gjedhit dhe e renditur në Pjesën 1 të Aneksit II të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2021/404:

II.2.2. have remained continuously:
II.2.2. kanë mbetur vazhdimisht:

(i) in the zone referred to in point II.2.1 since birth, or for a period time of at least 6 months prior to the date or their dispatch to the Republic of Albania, and

(i) në zonën e përmendur në pikën II.2.1 që nga lindja, ose për një periudhë të paktën 6 muaj para datës ose dërgimit të tyre në Republikën e Shqipërisë, dhe

(ii) in the estabilishment of origin since birth or for a period of time of at least 40 days prior to the date of their dispatch to the Republic of Albania, into wich during this period no bovine animals and no animals of other species listed for the same diseases as bovine animals have been introduced.

(ii) në stabilimentin e origjinës që nga lindja ose për një periudhë kohore prej të paktën 40 ditësh para datës së dërgimit të tyre në Republikën e Shqipërisë, në të cilat gjatë kësaj periudhe nuk ka kafshë gjedhi dhe nuk ka hyrë asnjë kafshë e specieve të tjera të listuara për të njëjtat sëmundje si të gjedhit.

II.2.3. had no contact with animals of a lower health status since birth or least for 30 days prior to the date of their dispatch to the Republic of Albania.

II.2.3. nuk ka pasur kontakt me kafshë të një statusi më të ulët shëndetësor që nga lindja ose të paktën për 30 ditë përpara datës së dërgimit të tyre në Republikën e Shqipërisë.

II.2.4. are not to be killed under a national programme for the eradication of diseases, including the relevant listed diseases referred to in Annex 1 to Commission Delegated Regulation (EU) 2020/692 and emerging diseases.

nuk duhet të vriten sipas një programi kombëtar për çrrënjosjen e sëmundjeve, duke përfshirë sëmundjet përkatëse të listuara të përmendura në Aneksin 1 të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2020/692 dhe sëmundjet emergjente.

(1) ***either*** **[II.2.5. have been dispatched directly from their establishment of origin to the Republic of Albania without passing through any other establishment].**

(1) ose [II.2.5. janë dërguar drejtpërdrejt nga stabilimenti i tyre e origjinës në Republikën e Shqipërisë pa kaluar nëpër ndonjë stabiliment tjetër].

(1) **or [II.2.5. have undergone one single assembly operation in the zone of origin fulfilling the following requirements:**

(1) ose [II.2.5. i janë nënshtruar një grumbullimi në zonën e origjinës duke plotësuar kërkesat e mëposhtme:

(a) the assembly operation took place in an establishment:

(a) grumbullimi është zhvilluar në një stabiliment:

(i) approved for conducting assembly operations of ungulates by the competent authority of Republic of ……. or territory in accordance with Article 5 of Delegated Regulation (EU) 2019/2035;

(i) janë miratuar për kryerjen e grumbullimit të thundrakëve nga autoriteti kompetent i Republikës së ..... ose territorin në përputhje me nenin 5 të Rregullores së deleguar (BE) 2019/2035;

(ii) wich has an unique approval number assigned by the competent authority of Republic of …… or territory of origin;

(ii) që ka një numër unik miratimi të caktuar nga autoriteti kompetent i Republikës së ..... ose territorit të origjinës;

(iii) listed for that purpose by the competent authority of Republic of ……. or territory of dispatch with the information set out in Article 21 of Delegated Regulation (EU) 2019/2035;

(iii) të listuara për këtë qëllim nga autoriteti kompetent i Republikës së ..... ose territorit të dërgesës me informacionin e përcaktuar në nenin 21 të Rregullores së deleguar (BE) 2019/2035;

(iv) fulfilling the requirements provided for in Article 8 of Delegated Regulation (EU) 2020/692.

(iv) përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 8 të Rregullores së deleguar (BE) 2020/692.

(b) the assembly operation in the assembly centre took no longer than 6 days.]

(b) grumbullimi në qendrën e grumbullimit zgjati jo më shumë se 6 ditë.]

II.2.6. have not been unloaded in any place that does not comply with the requirements laid down in point II.2.11. since they were dispatched from their establishment of origin until they are loaded for dispatch to the Republic of Albania and during that period they have not been in contact with animals of a lower health status.

nuk janë shkarkuar në asnjë vend që nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën II.2.11. që kur janë dërguar nga vendi i tyre i origjinës deri sa janë ngarkuar për dërgim në Republikën e Shqipërisë dhe gjatë asaj periudhe nuk kanë qenë në kontakt me kafshë me status më të ulët shëndetësor.

II.2.7. are loaded for dispatch to the Republic of Albania on / / (dd/mm/yyyy)(3) in a means of transport which was cleaned and disinfected prior to loading with a disnfectant authorised by the competent authority of the country or territory and constructed in such in such a way that:

janë ngarkuar për dërgim në Republikën e Shqipërisë më / / (dd/mm/vvvv)(3) në mjete transporti të cilat janë pastruar dhe dezinfektuar para ngarkimit me një dezinfektues të autorizuar nga autoriteti kompetent i vendit ose territorit të tretë dhe të ndërtuara në atë mënyrë që:

:

(i) animals cannot escape or fall out;

kafshët nuk mund të lëvizin ose të bien;

(ii) visual inspection of the space where animals are kept is possible;

është i mundur inspektimi vizual i hapësirës ku mbahen kafshët;

(iii) the escape of animal excrements, litter or feed is prevemted or minimized.

Është parandaluar ose minimizuar lëvizja e jashtëqitjeve, mbeturinave ose ushqimit të kafshëve.

II.2.8. have been subjected to a clinical inspection within the last 24 hour period prior to loading for dispatch to the Republic of Albania, carried out by an official veterinarian in Republic of …….. or territory of origin, who did not detect signs indicative of the occurrence of diseases, including the listed diseases referred to in Annex I to Delegated Regulation (EU) 2020/692 relevant for the species and emerging diseases.

Kanë qenë subjekt i një inspektimi klinik brenda periudhës 24 orëve të fundit përpara ngarkimit për dërgim në Republikën e Shqipërisë, të kryer nga një veteriner zyrtar në Republikën e ..... ose territorin e origjinës, i cili nuk ka zbuluar shenja që tregojnë shfaqjen e sëmundjeve, duke përfshirë sëmundjet përkatëse të listuara në Aneksin I të Rregullores së Deleguar (BE) 2020/692 për speciet e veçanta dhe sëmundjet emergjente.

II.2.9. have not been vaccinated against:

nuk janë vaksinuar kundër:

(i) foot and mouth disease, infection with Rift Valley fever virus, infection with *Mycoplasma mycoides* subsp. *mycoides* SC (Contagious

bovine pleuropnemonia), Mycobacterium tuberculosis complex (M. bovis, M. caprae and M. tuberculosis) and infection with Brucella abortus, B. Melitensis and B. Suis, and
sëmundjes së Aftë epizootike, infeksionit me virusin të Rift Valley, infeksionit me *Mycoplasma mycoides* subsp. *mycoides* SC (Pleuropnemonia ngjitëse e gjedhit), Mycobacterium tuberculosis kompleks (M. bovis, M. caprae dhe M. tuberculosis) dhe infeksionit me *Brucella abortus, B. Melitensis dhe B. Suis*, dhe

(ii) infection with bluetongue virus (serotypes 1-24) with a live vaccine during 60 days prior to their dispatch to the Republic of Albania.
infeksionit me virusit të gjuhës blu (serotipet 1-24) me një vaksinë të gjallë gjatë 60 ditëve përpara dërgimit të tyre në Republikën e Shqipërisë.

II.2.10. come from a zone:
II.2.10. vijnë nga një zonë:

II.2.10.1. in which:
II.2.10.1. në të cilën:

(i) foot and mouth disease has not been reported for:
(i) sëmundja e Afta Epizootike nuk është raportuar për:

(1) either **[at least 24 months prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania]**
(1) ose [të paktën 24 muaj përpara datës së dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë]

(1) (4) or **[since / / (dd/mm/yyyy)**
(1) (4) ose [që nga __/__/__ (dd/mm/vvvv)

(ii) vaccination against foot and mouth disease has not been carried out for at least 12 month prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania, and no animals vaccinated against foot and mouth disease have been introduced during that period.
vaksinimi kundër sëmundjes Aftës Epizootike nuk është kryer për të paktën 12 muaj përpara datës së dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë dhe asnjë kafshë e vaksinuar kundër sëmundjes Afta Epizootike nuk është futur gjatë kësaj periudhe./

II.2.10.2. in which infection with lumpy skin disease virus has not been reported for at least 12 months prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania.
II.2.10.2. në të cilat infeksioni me virusin e sëmundjes së Dermatozës Nodulare nuk është raportuar për të paktën 12 muaj përpara datës së dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë.

II.2.10.3. in which infection with rinderpest virus, infection with Rift Valley fever virus and infection with Mycoplasma mycoides subsp. mycoides SC (Contagious bovine pleuropneumonia) has not been reported for at least 12 months prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania and during that period:
II.2.10.3. në të cilin infeksioni me virusin e rinderpest, infeksioni me virusin e Rift Valley dhe infeksioni me *Mycoplasma mycoides* subsp. mycoides SC (Pleuropneumonia ngjitëse e gjedhit) nuk është raportuar për të paktën 12 muaj përpara datës së dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë dhe gjatë asaj periudhe:

(i) vaccination against these diseases has not been carried out;
vaksinimi kundër këtyre sëmundjeve nuk është kryer;

(ii) animals vaccinated against these diseases have not been introduced.
nuk kanë hyrë kafshët e vaksinuara kundër këtyre sëmundjeve.

(1)(5) either [II.2.10.4 which is free from infection with bluetongue virus (serotypes 1-24)]
(1)(5) ose e cila është e lirë nga infeksioni me virusin e gjuhës blu (serotipet 1-24)]

(1) or [II.2.10.4 wich is seasonally free from infection with bluetongue virus (serotypes 1-24);
(1) ose [II.2.10.4 që është sezonalisht pa infeksion me virusin e gjuhës blu (serotipet 1-24);

(1)(6) either [II.2.10.4.1. for at least 60 days prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania.]
(1)(6) ose [II.2.10.4.1. për të paktën 60 ditë përpara datës së dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë.]

(1) (6) or for at least 28 days prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania and animals have been subjected to a serological test in accordance with Article 9 (b) of Delegated Regulation (EU) 2020/692, with negative results, carried out on samples collected at least 28 days following the date of entry of the animal into the seasonally free zone.]
(1) (6) ose për të paktën 28 ditë përpara datës së dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë dhe kafshët i janë nënshtruar një testi serologjik në përputhje me nenin 9(b) të Rregullores së deleguar (BE) 2020/692, me rezultate negative, të kryera. në mostrat e mbledhura të paktën 28 ditë pas datës së hyrjes së kafshës në zonën e lirë sezonale.]

(1)(6) or for at least 14 days prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania and have been subjected to a PCR test, with negative results, carried out on samples collected at least 14 days following the date of entry of the animal in the seasonally free zone.]
(1)(6) ose [II.2.10.4.1. për të paktën 14 ditë para datës së dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë dhe i janë nënshtruar një testi PCR, me rezultate negative, të kryera në mostrat e mbledhura të paktën 14 ditë pas datës së hyrjes së kafshëve në zonën sezonalisht të lirë.]

(1) or [II.2.10.4 which is not free from infection with bluetongue virus (serotypes 1-24) and the animals have been vaccinated against all the serotypes (1 to 24) of bluetongue virus reported in that zone during the last 2 years prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania and are still within the immunity period of time guaranteed in the specifications of the vaccine, and:
(1) ose [II.2.10.4 nuk janë të lirë nga virusi i gjuhës blu (serotipet 1-24) dhe kafshët janë vaksinuar kundër të gjithë serotipeve (1 deri në 24) të virusit të gjuhës blu të raportuar gjatë 2 viteve të fundit në atë zonë gjatë 2 viteve të fundit përpara datës së dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë dhe janë ende brenda periudhës kohore të imunitetit të garantuar në specifikimet e vaksinës, dhe:

(1) either have been vaccinated more than 60 days prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania.]]
(1) ose janë vaksinuar më shumë se 60 ditë përpara datës së dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë.]]

(1) or have been vaccinated with an inactivated vaccine and were subjected to a PCR test, with negative results on samples collected at least 14 days after the date of onset of the immunity protection set in specifications of the vaccine.]](1)
(1) ose janë vaksinuar me një vaksinë të inaktivizuar dhe i janë nënshtruar një testi PCR, me rezultate negative në mostrat e mbledhura të paktën 14 ditë pas datës së fillimit të mbrojtjes së imunitetit të vendosur në specifikimet e vaksinës.]](1)

(1) or [II.2.10.4. which is not free from infection with bluetongue virus (serotypes 1-24) and the animals have been subjected with positive results to a serological test able to detect specific antibodies against all serotypes (1 to 24) of bluetongue virus reported in that zone during the last 2 years prior to the date of dispatch of the animals to Republic of Albania, and:
(1) ose [II.2.10.4. nuk është i lirë nga infeksioni me virusin e gjuhës blu (serotipet 1-24) dhe kafshët i janë nënshtruar me rezultate pozitive një testi serologjik të

aftë për të zbuluar antitrupa specifikë kundër të gjithë serotipeve (1 deri në 24) të virusit të gjuhës blu të raportuar gjatë 2 viteve të fundit në atë zonë para datës së dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë, dhe:

(1) **either [II.2.10.4.1. the serological test has been carried out on samples collected at least 60 days prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania.]]**
(1) ose [II.2.10.4.1. testi serologjik është kryer në mostrat e mbledhura të paktën 60 ditë përpara datës së dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë.]]

(1) **or [II.2.10.4.1. the serological test has been carried out on samples collected at least 30 days prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania and the animals were subjected to a PCR test, with negative results, carried out on samples collected not earlier than 14 days prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania.]]**
II.2.12.1. i cili është regjistruar nga dhe nën kontrollin e autoritetit kompetent të vendit ose territorit të tretë të origjinës dhe ka një sistem të mbajtur për të paktën 3 vjet pas datës së hyrjes së kafshëve në Republikën e Shqipërisë me të dhëna të përditësuara që përmbajnë informacion në lidhje me:
(i) **the species, categories, number and identification of animals on the establishment;**
(i) speciet, kategoritë, numrin dhe identifikimin e kafshëve në stabiliment;
(ii) **movements of animals into and out of the establishment;**
(ii) lëvizjet e kafshëve brenda dhe jashtë stabilimentit;
(iii) **mortality in the establishment**.
(iv) vdekshmëria në stabiliment.

II.2.12.2. which receives regular animal health visits from a veterinarian for the purpose of the detection of, and information on, signs indicative of the occurrence of diseases, including the listed diseases referred to in Annex I to Delegated Regulation (EU) 2020/692 relevant for the species and emerging diseases, at a frequency that is proportional to the risk posed by the establishment.
II.2.12.2. në të cilin merr vizita shëndetësore rregullisht nga një veteriner me qëllim zbulimin dhe marrjen e informacionit mbi shenjat që tregojnë shfaqjen e sëmundjeve, duke përfshirë sëmundjet e listuara të përmendura në Aneksin I të Rregullores së Deleguar (BE) 2020/692 relevante për speciet dhe sëmundjet emergjente, në një frekuencë që është në përpjesëtim me rrezikun që paraqet stabilimenti.

II.2.12.3. which was not subject to national restriction measures for animal health reasons, including the relevant listed diseases referred to in Annex I to Delegated Regulation (EU) 2020/692 relevant for the species and emerging diseases, at the date of dispatch to the Republic of Albania.
II.2.12.3. i cili nuk ka qenë nën masa kufizuese kombëtare për arsye të shëdetit të kafshëve, duke përfshirë sëmundjet përkatëse të listuara relevantë të specieve të përmendura në Aneksin I të Rregullores së Deleguar (BE) 2020/692 dhe sëmundjet emergjente, në kohën e dërgimit në Republikën e Shqipërisë.

II.2.12.4. in and around which, in an area with a 10 km radius, including where appropriate the territory of a neighbouring country, none of the following listed diseases has been reported for at least 30 days prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania: foot and mouth disease, infection with rinderpest virus, classical swine fever and African swine fever.
II.2.12.4. në dhe rreth së cilit, në një zonë me një rreze prej 10 km, duke përfshirë aty ku është e përshtatshme territorin e një vendi fqinj, asnjë nga sëmundjet e listuara në vijim nuk është raportuar për të paktën 30 ditë përpara dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë: Sëmundja e Aftës Epizootike, infeksioni me virusin rinderpest, murtaja klasike e derrave dhe murtaja Afrikane e derrave.

either **[II.2.12.5. in which infection with *Brucella abortus, B. melitensis* and *B. suis* has not been reported during the last 42 days prior to**

dispatch of animals to the Republic of Albania and in which during the last 12 month prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania the biosecurity and risk mitigating measures, including housing conditions and feeding systems, have been applied as necessary to prevent transmission of infection with Brucella abortus, B. melitensis and B. suis from wild animals of listed species to porcine animals kept on the establishment and only porcine animals from establishments applying equivalent biosecurity measures have been introduced [1]

II.2.12.5. [në të cilën infeksioni me Brucella abortus, B. melitensis dhe B. suis nuk është raportuar gjatë 42 ditëve të fundit para dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë dhe në të cilat gjatë 12 muajve të fundit përpara dërgimit në Republikën e Shqipërisë, masat e biosigurisë dhe zbutjes së rrezikut, duke përfshirë kushtet e strehimit dhe sistemet e të ushqyerit, janë zbatuar sipas nevojës për të parandaluar transmetimin e infeksionit me Brucella abortus, B. melitensis dhe B. suis nga kafshët e egra të specieve të listuara të kafshëve të llojit derra që mbahen në stabiliment dhe janë futur vetëm kafshët e llojit derra nga stabilimentet që aplikojnë masa ekuivalente të biosigurisë [1].

or II.2.12.5 [in which infection with Brucella abortus, B. melitensis and B. suis has not been reported during the last 42 days prior to dispatch of the animals to the Republic of Albania and in which during the last 12 month prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania a surveillance with infection with Brucella abortus, B. melitensis and B. suis has been carried out on the porcine animals kept in the establishment in accordance with Annex III to Commission Delgated Regulation (EU) 2020/688, and during that period [1]**:**

ose **II.2.12.5** [në të cilat nuk është raportuar infeksioni me *Brucella aborrus, B. melitensis dhe B. Suis* gjatë 42 ditëve të fundit para dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë dhe në të cilat gjatë 12 muajt e fundit para datës së nisjes së kafshëve në Republikën e Shqipërisë është kryer një mbikqyrje për infeksionin me Brucella abortus, B. melitensis dhe B. suis në kafshët e derrave të mbajtura në përputhje me Shtojcën III të Rregullores së deleguar të Komisionit (BE) 2020/688, dhe gjatë asaj periudhe[1]:

- **only porcine animals from establishments applying such surveillance or biosecurity measures introduced, and**
- vetëm kafshët e llojit derra nga stabilimentet që zbatojnë masat e mbikëqyrjes dhe masat e biosigurisë që janë futur në stabiliment, dhe
- **in the case where infection with *Brucella abortus, B. melitensis and B. suis* has been reported in porcine animals kept there in, measures were taken in accordance with Part 1(3) of Annex II to Delegated Regulation (EU) 2020/688].** [1]
- - në rastin kur infeksioni me Brucella abortus, B. melitensis dhe B. suis të raportuar për derrat e mbajtur, janë marrë masa në përputhje me Pjesën 1(3) të Aneksit II të Rregullores së Deleguar (BE) 2020/688]. [1]

11.2.12.6. in which infection with Aujeszky's disease virus has not been reported for at least the 30 days prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania;
11.2.12.6. në të cilat infeksioni me virusin e sëmundjes së Aujeskut nuk është raportuar për të paktën 30 ditë përpara datës së dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë;

[II.2.12.7. in which rabies has not been reported for at least the 30 days prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania] [1] [7]**;**
[II.2.12.7. në të cilat tërbimi nuk është raportuar për të paktën 30 ditë përpara datës së dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë] [1] [7];

11.2.12.8. in which anthrax has not been reported for at least the 15 days prior to the date of dispatch of the animals to the Republic of Albania
11.2.12.8. në të cilat antraksi nuk është raportuar për të paktën 15 ditë përpara datës së dërgimit të kafshëve në Republikën e Shqipërisë.

[either [II.2.13.originate from a country or territory, or zone thereof free from infection with Aujeszky's disease virus [1] [8]**;]** [1] [9]**;**
[ose [II.2.13. e kanë origjinën nga një vend, territor ose zonë e tij që është e lirë nga infeksioni me virusin e sëmundjes së Aujeskut [1] [8];] [1] [9];

or [II.2.13. [(a) have not been vaccinated against infection with Aujeszky's disease virus, [1] [7]
nuk janë vaksinuar kundër infeksionit me virusin e sëmundjes së Aujeskut, [1] [7]

(b)were kept in an approved quarantine establishment for at least 30 days,
janë mbajtur në një stabiliment të miratuar karantine për të paktën 30 ditë

(c) were subject to a serological test for the detection of antibodies against whole Aujeszky's disease virus with the diagnostic methods provided for in Part 7 of Annex I to Delegated Regulation (EU) 2020/688, with a negative result carried out on samples taken on two occasions at an interval of not less than 30 days, the last sample taken during the period of 15 days prior to the date of dispatch to the Republic of Albania.]][1][7]
kanë qenë subkejt i një testi serologjik për zbulimin e plotë të antitrupave kundër sëmundjes së Aujeskut me metodat diagnostikuese të parashikuara në Pjesën 7 të Aneksit I të Rregullores së Deleguar (BE) 2020/688, me një rezultat negativ të kryer në mostrat e marra në dy herë në një interval jo më pak se 30 ditë, mostra e fundit e marrë gjatë periudhës 15 ditë përpara datës së dërgimit në Republikën e Shqipërisë.]][1][7]

Notes
Shënime/

This animal health/ official certificate is intended for porcine animals and animals of the family Tayassuidae that will be slaughtered in the Republic of Albania.
Kjo certifikatë shëndetësore të kafshëve/ zyrtare ka për qëllim hyrjen e kafshëve të llojit derra dhe kafshët e familjes Tayassuidae që do të theren në Republikën e Shqipërisë./

This animal health official certificate shall be completed according to the notes for the completion of certificates provided for in Chapter 4 of Anex I to Commission Implementing Regulation (EU) 2020/2235.
Kjo certifikatë zyrtare e shëndetit të kafshëve do të plotësohet sipas shënimeve për plotësimin e certifikatave të parashikuara në Kapitullin 4 të Aneksit I të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/2235./

Part I:
Pjesa I:/

Box reference 1.27: "Identification system and identification number" Specify the identification system (such as ear tag, tattoo, transponder etc., from the list in Annex III to Delegated Regulation (EU) 2019/2035) and the individual identification codes of the animals in accordance with Article 21(1) of Delegated Regulation (EU) 2020/692; or, for the zones with an entry "ID" in column 6 of the table in Part 1 of Annex II to Implementing Regulation (EU) 2020/692.
Referenca e kutisë 1.27: "Sistemi i identifikimit dhe numri i identifikimit" Specifikoni sistemin e identifikimit (si matrikulli i veshit, tatuazhi, transponderi etj., nga lista në Aneksin III të Rregullores së Deleguar (BE) 2019/2035) dhe kodet individuale të identifikimit të kafshëve në përputhje me nenin 21.1 të Rregullores së deleguar (BE) 2020/692; Për zonat me shënim "ID" në kolonën 6 të tabelës në Pjesën 1 të Aneksit II të Rregullores Zbatuese (BE) 2020/692.

Part II:
Pjesa II:/

(1) **Delete if not applicable.**/ Të fshihet sipas rastit.
(2) **Code of the zone as it appears in Column 2 of Part 1 of Annex II to Implementing Regulation (EU) 2021/404.**/ Kodi i zonës siç paraqitet në kolonën 2 të pjesës 1 të aneksit II të Rregullores Zbatuese (BE) 2021/404.
(3) **Only possible for porcine animals.** /E mundur vetëm për kafshët e llojit derra.
(4) Date of loading: it cannot be a date prior to the date of authorisation of the zone for entry into the Republic of Albania, or a date in a period when restriction measures have been adopted by the Republic of Albania against entries of these animals from this zone./Data e ngarkimit: nuk mund të jetë një datë para datës së autorizimit të zonës për hyrje në Republikën e Shqipërisë, ose një datë në një periudhë kur janë miratuar masa kufizimi nga Republika e Shqipërisë kundër hyrjeve të këtyre kafshëve nga kjo zonë.
(5) **Only for zones with opening date in accordance with column 8 in part 1 of Annex II to Implementing Regulation (EU) 2021/404.**/ Vetëm për shtetet me datë hapjeje në përputhje me kolonën 8 në pjesën 1 të Aneksit II të Rregullores Zbatuese (BE) 2021/404.
(6) **For zones with entry CSF in column 7 of Part 1 of Annex II to Implementing Regulation (EU) 2021/404.**/ Për shtetet që kanë shënimin MKD në kolonën 7 të Pjesës 1 të Aneksit II të Rregullores Zbatuese (BE) 2021/404.
(7) **Only applicable to ungulates of the family Suidae.**/Zbatohet vetëm për njëthundrakët e familjes Suidae.
(8) **Only applicable when the Member State of destination or Switzerland, in accordance with the Agreement between the European Community and the Swiss Confederation on trade in agricultural products (OJ L 114, 30.4.2002), either have disease-free or an approved eradication programme for the disease mentioned in point II.2.13 (infection with Aujeszky's disease virus).**/ Zbatohet vetëm kur shteti anëtar i destinacionit ose Zvicra, në përputhje me Marrëveshjen ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Konfederatës Zvicerane për tregtinë e produkteve bujqësore (OJ L 114, 30.4.2002), ose kanë status pa sëmundje për sëmundjen përkatëse të kategorisë C ose një program të miratuar çrrënjosjeje.
(9) **For the zones with entry ADV in column 7 of Part I of Annex II to Implementing Regulation (EU) 2021/404 recognised free from infection with Aujeszky's disease virus or with an approved eradication programme and fulfilling the requirements in Regulation (EU) 2020/689.** / Për vendet që kanë shënimin ADV në kolonën 7 të Pjesës I të Shtojcës II të Rregullores Zbatuese (BE) 2021/404 të njohura të lira nga infeksioni me virusin e sëmundjes së Aujeskut ose me një program të miratuar çrrënjosjeje dhe që përmbushin kërkesat në Rregulloren (BE) 2020/689.
(10) **Only for third countries listed in Article 13(2) of Implementing Regulation (EU) 2015/1375.**/Vetëm për vendet e treta të listuara në nenin 13(2) të Rregullores Zbatuese (BE) 2015/1375.

Official veterinarian
Veterineri zyrtar/

Name (in Capital letters):
Emri (me gërma kapitale):/

Date:
Data/

Stamp
Vula/

Qualification and title:
Kualifikimi dhe titulli:/

Signature:
Firma:/

PJESA 3
ADDENDUM FOR TRANSPORT OF ANIMALS BY SEA/SHTESË PËR TRANSPORTIN E KAFSHËVE PËRMES DETIT

(To be completed and attached to the veterinary certificate when transport to the Republic of Albania frontier includes, even for part of the journey, transportation by ship.)
(Të plotësohet dhe t'i bashkëlidhet certifikatës veterinare, kur transporti për në kufijtë e RSH përfshin edhe për pjesë të udhëtimit, transportin me anije)

Declaration by the master of the ship
Deklarata nga kapiteni i anijes
I, the undersigned, master of ship (name .....), declare that the animals referred to in the attached veterinary certificate No ..... have remained on board the ship during the voyage from
Unë, i nënshkruari, kapiten i anijes (emri .....), deklaroj se kafshët e përmendura në certifikatën veterinare bashkëlidhur me nr. ..... kanë qëndruar në bordin e anijes gjatë udhëtimit nga
..... in..... (*exporting country*) to ..... in Republic of Albania and that the ship did not call at any place

outside..... (*exporting country*) en route to Republic of Albania other than: ..... (*Ports of call en route*). Moreover, during the journey, these animals have not been in contact with other animals on board of a lower health status.

..... në ..... (*vendi eksportues*) për në portin e ..... në Republikën e Shqipërisë dhe se anija nuk ka qëndruar në asnjë vend jashtë ……..... (*vendi eksportues*) në udhëtimin për në Republikën e Shqipërisë, përveçse: ..... (*portet e ndalesës gjatë udhëtimit*). Për më tepër, gjatë udhëtimit, këto kafshë nuk kanë qenë në kontakt me kafshë të tjera në bordin e anijes me një gjendje më të ulët shëndetësore.

Done at **on**

Deklaruar në ..... më .....

(Port of arrival/Porti i mbërritjes) **(Date of arrival/**Data e mbërritjes)

(signature of master)

(nënshkrimi i kapitenit

(stamp)

(vula)

(name in capital letters and title)

(emri dhe funksioni me germa kapitale)

PJESA 4

ADDENDUM FOR TRANSPORT OF ANIMALS BY AIR/ SHTESË PËR TRANSPORTIN E KAFSHËVE ME ANË TË AJRIT

(To be completed and attached to the veterinary certificate when transport to Republic of Albania frontier includes, even for part of the journey, transportation by air.)

(Të plotësohet dhe t'i bashkëlidhet certifikatës veterinare, kur transporti për në kufijtë e Republikës së Shqipërisë, përfshin edhe për pjesë të udhëtimit, transportin me avion)

Declaration by the master of the ship

Deklarata nga komandanti i avionit

I, the undersigned, captain of the aircraft (name .....), declare that the crate or container and the area around the crate or container containing the animals referred to in the attached veterinary certificate No …….has been sprayed with insecticide before departure.

Unë, i nënshkruari, komandant i avionit (emri .....), deklaroj se arkat ose kontejnerët dhe zona përreth arkave ose kontejnerëve që mbanin kafshët e përmendura në

certifikatën veterinare bashkëlidhur me nr. ..... janë spërkatur me insekticidë përpara nisjes.

Done at **on**
Deklaruar në ..... më .....
(Port of arrival/Porti i mbërritjes) **(Date of arrival/**Data e mbërritjes)

(signature of master)
(nënshkrimi i kapitenit)

(stamp)
(vula)

(name in capital letters and title)

(emri dhe funksioni me germa kapitale)

PJESA 5
KUSHTET PËR MIRATIMIN E QENDRAVE TË GRUMBULLIMIT (TË PËRMENDURA NË NENIN 4)

Qendrat e grumbullimit duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme, në mënyrë që të miratohen:

I. Ato duhet të mbikëqyren nga një veteriner zyrtar.

II. Secila prej tyre duhet të jetë e vendosur në qendër të një zone me një diametër të paktën 20 km, në të cilën, sipas njoftimeve zyrtare nuk ka pasur asnjë rast të "Aftës epizootike" për të paktën 30 ditë përpara përdorimit të tyre si qendra grumbullimi.

III. Përpara çdo përdorimi si qendra grumbullimi të miratuara ato duhet të pastrohen dhe të dezinfektohen me një dezinfektant zyrtarisht të autorizuar në vendin eksportues, si një mjet për të kontrolluar sëmundjen e "Aftës epizootike".

IV. Duke marrë në konsideratë kapacitetin e tyre mbajtës të kafshëve ato duhet të kenë:

a) një objekt të përcaktuar vetëm për t'u përdorur si një qendër grumbullimi;

b) ndërtime të përshtatshme, që pastrohen dhe dezinfektohen me lehtësi, me lehtësi për ngarkimin, shkarkimin dhe qëndrimin me standarde të përshtatshme për kafshët, ku kafshëve u sigurohet ujë dhe ushqim, si dhe trajtimi në rast nevoje;

c) ndërtime të përshtatshme për kontrollin dhe izolimin e kafshëve;

d) pajisje të përshtatshme për pastrimin dhe dezinfektimin e dhomave dhe kamionëve;

e) një mjedis të përshtatshëm për depozitimin e ushqimeve, shtresës dhe plehut;

f) një sistem të përshtatshëm për grumbullimin dhe eliminimin e ujërave të shkarkimeve (të zeza);

g) një zyrë për veterinerin zyrtar.

V. Gjatë punës, duhet të kenë një numër të mjaftueshëm veterinerësh për të kryer të gjitha detyrat e përcaktuara në pjesën 5;

VI. Në qendrat e grumbullimit do të pranohen kafshë që janë individualisht të matrikulluara në mënyrë që të sigurohet gjurmueshmëria. Për këtë qëllim, pronari ose personi përgjegjës për qendrën duhet të sigurohet që kafshët që pranohen duhet të jenë të matrikulluara siç duhet dhe të shoqëruara me dokumentet ose certifikatat shëndetësore për llojet dhe kategoritë e kafshëve.

Përveç kësaj, pronari ose personi përgjegjës për qendrën e grumbullimit duhet të shënojë në regjistër ose në një bazë të dhënash emrin e pronarit të kafshëve, origjinën e kafshëve, datat e hyrjes dhe të daljes, numrin identifikues të kafshëve ose numrin e regjistrimit te tufës së origjinës dhe të fermës ku do të shkojnë kafshët, numrin e regjistrimit të transportuesit dhe targën e kamionit që sjell ose grumbullon kafshët nga qendra e grumbullimit. Këto të dhëna mbahen për të paktën një periudhë 3-vjeçare.

VII. Të gjitha kafshët që kalojnë përmes një qendre grumbullimi duhet të plotësojnë kushtet shëndetësore të vendosura për hyrjen e kategorive të kafshëve në Republikën e Shqipërisë.

VIII. Kafshët që do të hyjnë në Republikën e Shqipërisë, që kalojnë përmes një qendre grumbullimi, brenda 6 ditëve nga mbërritja në qendrën e grumbullimit duhet të ngarkohen dhe të transportohen drejtpërsëdrejti për në kufirin e vendit eksportues:

a) pa rënë në kontakt me kafshët dythundrake me gjendje të ndryshme shëndetësore nga ato të përcaktuara për hyrjen e kategorive të kafshëve në Republikën e Shqipërisë;

b) me ngarkesa të veçuara në mënyrë të tillë që asnjë ngarkesë të mos përmbajë të dyja kategoritë e kafshëve, për mbarështim ose prodhim dhe të kafshëve për therje të menjëhershme;

c) në mjetet ose kontejnerët e transportit, që janë pastruar dhe dezinfektuar paraprakisht me një dezinfektant zyrtarisht të miratuar në vendin eksportues, si një mënyre për të kontrolluar sëmundjen e "Aftës epizootike" dhe që janë ndërtuar në mënyrë të tillë që: jashtëqitjet, urina, shtresa ose ushqimi, të mos rrjedhin ose bien jashtë gjatë transportit.

IX. Kur kushtet për eksportin e kafshëve për në Republikën e Shqipërisë kërkojnë kryerjen e një testi brenda një periudhe të caktuar kohe përpara ngarkimit, kjo periudhë duhet të përfshijë çdo periudhë të grumbullimit deri në 6 ditë nga data e mbërritjes së kafshëve në qendrën e miratuar të grumbullimit.

X. Vendi eksportues duhet të përcaktojë qendrat që janë miratuar për kafshët për mbarështim dhe prodhim dhe qendrat që janë miratuar për kafshët për therje dhe duhet të njoftojë autoritetin kompetent qendror të Republikës së Shqipërisë për emrat dhe adresat e këtyre qendrave. Ky informacion duhet të përditësohet rregullisht.

XI. Vendi eksportues duhet të përcaktojë procedurën për mbikëqyrjen zyrtare të qendrave të miratuara të grumbullimit dhe të sigurojë kryerjen faktike të mbikëqyrjes zyrtare.

XII. Qendrat e miratuara të grumbullimit duhet të kontrollohen rregullisht nga autoriteti kompetent i vendit eksportues në mënyrë që të kontrollojë se kërkesat për miratimin e tyre të përcaktuara në pikat I në XI plotësohen në vijimësi.

Nëse nga këto kontrolle rezulton se këto kushte nuk plotësohen më, miratimi i qendrës pezullohet. Miratimi mund të rikthehet vetëm kur autoriteti kompetent i vendit eksportues sigurohet se qendra plotëson tërësisht kushtet e përcaktuara në pikat I në XI.

PJESA 6
PROTOKOLLET PËR STANDARDIZIMIN E MATERIALEVE DHE PROCEDURAVE TË TESTIMIT (TË PËRMENDURA NË NENIN 5)

1. TUBERKULOZI

Kryhet një test i vetëm tuberkuline intradermal, duke përdorur tuberkulinë gjedhi, në përputhje me aneksin B të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit nr.255, datë 10.6.2008. Në rastin e kafshëve të familjes së derrave, kryhet një test i vetëm tuberkuline të inokuluar intradermal, duke përdorur tuberkulinen aviare, në përputhje me aneksin B të Rregullores së miratuar me urdhër të ministrit nr.255, datë 10.6.2008, me ndryshimin se vendi i injektimit duhet të jetë pjesa e lirshme e lëkurës në bazën e veshit.

2. BRUCELOZA (Brucella abortus)

Testi i aglutinimit të serumit, testi i lidhjes së komplementit, testi i antigjenit brucelar buferik, testet ELISA dhe testi i polarizimit të fluoreshencës (FPA), kryhen në përputhje me aneksin C të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit nr.255, datë 10.6.2008 "Mbi problemet e shëndetit të kafshëve të llojeve gjedh dhe derra". Testet e Brucelozës (Brucella melitensis) kryhen në përputhje me shtojcën C të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit nr.187, datë 11.6.2009 "Mbi rregullat e shëndetit të kafshëve në tregtinë e të imtave".

3. LEUKOZA ENZOOTIKE E GJEDHIT

Testi i agar-xhel immuno-difuzionit (AGID) dhe testi ELISA, kryhen në përputhje me paragrafët A dhe C të kapitullit II të aneksit D të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit nr.255, datë 10.6.2008 "Mbi problemet e shëndetit të kafshëve të llojeve gjedh dhe derra".

4. GJUHA BLU (BLUTONGUE)

4. A. Testi ELISA bllokues ose konkurrues kryhet sipas protokollit të mëposhtëm:

ELISA konkurruese duke përdorur antitrupa monoklonalë 3-17-A3 është e aftë për identifikimin e antitrupave të të gjitha serotipeve të njohur të virusit të "Gjuhës blu" (BTV).

Parimi i testit është ndërprerja e reagimit midis antigjenit BTV dhe një grupi të antitrupave specifike monoklonale (3-17-A3) nga shtimi i antitrupave të serumit që testohet.

Antitrupat ndaj BTV të pranishëm në serumet që testohen bllokojnë reaktivitetin e antitrupave monoklonalë (Mab) dhe rezultojnë në një ulje në zhvillimin e ngjyrës që pritet pas shtimit të antitrupave antiminj, dhe kromogjenit/substratit. Serumet mund të testohen në një

hollim të vetëm 1:5 (testi i njollës - shtojca 1) ose mund të titrohen (titrimi i serumeve - shtojca 2) për të dhënë pikën e fundit të hollimit. Vlerat inhibuese më të larta se 50% mund të konsiderohen si pozitive.

4. A.1. Materiale dhe reagente

1. Pllaka mikrotitrimi ELISA.

2. Antigjen: furnizuar si një ekstrakt qelizor i koncentruar, të përgatitur siç përshkruhet më poshtë, dhe të ruajtura në - 20 ° C ose - 70 ° C.

3. Bufer bllokues: kripë fosfat bufer (PBS) qe përmban 0,3% serum gjedhi të rritur negativ për BTV; 0,1% (v/v) Tween-20 (furnizuar si sorbiton polyoxyethylene monolaurate) në PBS.

4. Antitrupa monoklonalë: 3-17-A3 (furnizuar si kulturë supernatanti hybridome) drejtuar kundër polipeptideve grupspecifike VP7, ruhet në - 20°C ose i tharë me ngrirje dhe hollohet 1/100 me bufer bllokues para përdorimit.

5. Konjugati: globuline lepuri antimi (adsorbuar dhe eluuar) konjuguar me peroksidase dhe mbajtur në errësirë në 4°C.

6. Kromogjen dhe substrat: Orthophenylene diamine (OPD-chromogen) në një koncentrim të fundit prej 0,4 mg / ml në ujë steril te distiluar. Ujë i oksigjenuar (30% ë /-v substrati) 0,05% v / v shtohet menjëherë para përdorimit (5µl O2 H2 për 10 ml OPD). (Mbani OPD me kujdes - vishni doreza gome – dyshohet si kancerogjen).

7. Acid sulfurik 1 Molar: 26,6 ml të acidit shtohen në 473,4 ml ujë të distiluar. (Kujdes! Acidi duhet të shtohet në ujë, nuk shtohet ujë në acid.).

8. Tundës orbital.

9. Lexues ELISA (testi mund të lexohet me sy).

4. A.2. Formati i testit

Cc: kontrolli i konjugatit (pa serum / pa antitrupa monoklonalë);

C + +: serum i fortë pozitiv kontrolli;

C +: serum i dobët pozitiv kontrolli;

C - : serum negativ kontrolli;

Cm: kontrolli monoklonal i antitrupave (pa serum).

Shtojca 1. Hollimi (1:5) format (40 serume / pllakë)

Listen

Read phonetically

Dictionary - View detailed dictionary

	Kontrollet		**Serumet që testohen**									
	1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**	**10**	**11**	**12**
A	Cc	C-	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
B	Cc	C-	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
C	C++	C++										
D	C++	C++										
F	C+	C+										
E	C+	C+										
G	Cm	Cm										40

H	Cm	Cm										40

Shtojca 2. Formati i titrimit të serumeve (10 serume/pllakë)

	Kontrollet		**Serumet që testohen**									
	1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**	**10**	**11**	**12**
A	Cc	C-	1:5									1:5
B	Cc	C-	1:10									1:10
C	C++	C++	1:20									1:20
D	C++	C++	1:40									1:40
F	C+	C+	1:80									1:80
E	C+	C+	1:160									1:160
G	Cm	Cm	1:320									1:320
H	Cm	Cm	1:640									1:640

4. A.3. Protokolli i testit:

Kontrolli i konjugatit (Cc): Pusetat 1A dhe 1B janë një kontroll i bardhë që përbëhen nga antigjen BTV dhe konjugat. Kjo mund të përdoret për të kontrolluar lexuesin ELISA.

Kontrolli i antitrupave monoklonale (Cm): Kolonat 1 dhe 2, rreshtat G dhe H janë kontrolli i antitrupave monoklonale dhe përmbajnë antigjen BTV, antitrupa monoklonale dhe konjugat. Këto puseta paraqesin ngjyrën maksimale. Mesatarja e leximit të densitetit optik nga ky kontroll paraqet vlerë inhibimi 0 %.

Kontrolli pozitiv (C++, C+): Kolonat 1 dhe 2, rreshtat C-D-E-F. Këto puseta përmbajnë antigjen BTV, antiserum pozitiv të fortë dhe të dobët BTV, antitrupa monoklonale dhe konjugat.

Kontrolli negativ (C-): Pusetat 2A dhe 2B janë kontrollet negative, të cilat përmbajnë antigjen BTV, antiserum negativ BTV, antitrupa monoklonale dhe konjugat.

Serumet që testohen: Për survejime serologjike në shkallë të gjerë dhe teste të shpejta zbulimi, serumet duhet të testohen në një hollim të vetëm 1:5 (shtojca 1). Në të kundërt, 10 serume mund të testohen në një raport hollimi nga 1:5 deri 1:640 (shtojca 2). Kjo do të japë një të dhënë mbi titrin e antitrupave në serumet që testohen.

4.A.4. Procedura:

1. Hollohet antigjeni BTV (virusi i "Gjuhës blu") në përqendrimin e paratitruar në PBS (PBS- fosfat buffer saline), vendoset në sonikator për një kohë të shkurtër për të shpërndarë virusin e grumbulluar (nëse nuk ka sonikator, pipetohet me forcë për të siguruar të njëjtin efekt) dhe shtohen 50 µl në të gjitha pusetat e pllakës ELISA. Goditen lehtë anët e pllakës për të shpërndarë antigjenin.

2. Inkubohet pllaka ELISA në 37°C për 60 minuta në një tundës që rrotullohet. Shpëlahen pllakat tri herë duke mbushur dhe zbrazur pusetat me PBS josterile dhe thahet në një letër absorbuese.

3. Pusetat e kontrollit: Shtohen 100 µl bufer bllokues në pusetat Cc. Shtohen 50 µl serume pozitive dhe negative të kontrollit në hollimin 1:5 (10 µl serum + 40 µl bufer bllokues), në pusetat respektive C-, C+ dhe C++. Shtohen 50 µl bufer bllokues në pusetat e kontrollit Mab (antitrupat monoklonalë – Mab).

Metoda e titrimit me pikë: Shtohet një hollim 1:5 i çdo serumi që testohet në buferin bllokues për të dyfishuar pusetat e kolonave 3 deri në 12 (10 µl serum + 40 µl bufer bllokues), ose

Metoda e titrimit të serumit: Përgatitet një seri hollimesh dyfishe e çdo kampioni që testohet (1:5 deri 1:640) në bufer bllokues në 8 pusetat e një kolone të vetme nga 3 deri në 12.

4. Menjëherë pas shtimit të serumeve që testohen, hollohet Mab 1:100 në bufer bllokues dhe shtohen 50 µl në të gjitha pusetat e pllakës me përjashtim të kontrollit të bardhë (kontrolli i

reaksionit).

5. Inkubohet pllaka ELISA në 37°C për 60 minuta në një tundës që rrotullohet. Shpëlahet 3 herë me PBS dhe lihet të thahet.

6. Hollohen antitrupat antimi të prodhuara në lepuj në përqendrimin 1/5000 në bufer bllokues dhe shtohen 50 µl në të gjitha pusetat e pllakës.

7. Inkubohet pllaka në 37°C për 60 minuta në një tundës që rrotullohet. Shpëlahet 3 herë me PBS dhe lihet të thahet.

8. Shkrihet OPD-në (ortofenildiaminën) dhe menjëherë përpara përdorimit shtohen 5 µl peroksid hidrogjeni 30% në 10 ml OPD. Shtohen 50 µl në të gjitha pusetat e pllakës. Lejohet zhvillimi i ngjyrës për afërsisht 10 minuta, pas së cilës ndalohet reaksioni me acid sulfurik 1 M (50 µl për pusetë). Ngjyra duhet të zhvillohet në pusetat e kontrollit Mab dhe në ato puseta që përmbajnë serume pa antitrupa ndaj BTV (virusit të "Gjuhës blu").

9. Ekzaminohet pllaka me sy të lirë ose me një lexues spektrofotometrik dhe regjistrohen rezultatet.

4. A.5. Analizimi i rezultateve:

Duke përdorur programin kompjuterik, shtypen vlerat OD (Densiteti Optik), dhe përqindja e inhibimit (PI) për serumet e kontrollit dhe ato që testohen, mbështetur në vlerën mesatare të regjistruar në pusetat e kontrollit të antigjenit. Të dhënat e shprehura si vlera OD dhe PI përdoren për të përcaktuar nëse testi është kryer brenda kufijve të pranueshëm. Kufijtë e kontrollit të sipërm (UCL) dhe kufijtë e kontrollit të poshtëm (LCL) për kontrollin Mab (antigjen plus Mab në mungesë të serumeve që kontrollohen) janë vlerat e OD midis 0.4 dhe 1.4. Çdo pllakë që nuk përmbush kriteret e mësipërme nuk duhet të pranohet.

Në mungesë të programit kompjuterik, vlerat OD shtypen duke përdorur printerin e ELISA. Llogaritet vlera mesatare OD për pusetat e kontrollit të antigjenit, e cila është e barasvlershme me vlerën 100%. Përcaktohet vlera 50% OD dhe përllogaritet (me dorë) pozitiviteti dhe negativiteti i çdo kampioni.

Përqindja e inhibimit (vlera PI) = 100 – (OD e çdo kontrolli të testit/mesataren OD të Cm) x 100

Pusetat dublikate të serumeve të kontrollit negativ dhe pusetat dublikate të kontrolleve të bardhë duhet të regjistrojnë vlera PI midis +25% dhe -25%, dhe midis + 95% dhe + 105%, përkatësisht. Nëse vlerat nuk janë brenda këtyre kufijve, kjo nuk e nxjerr pllakën të pavlefshme, por sugjeron që është duke u zhvilluar ngjyra.

Serumet e kontrollit pozitiv të dobët dhe të fortë duhet të regjistrojnë vlera PI midis + 81 % dhe + 100 %, dhe midis + 51 % dhe 80 %, përkatësisht.

Vlera kufi diagnostike për serumet që testohen është 50% (PI 50% ose OD 50%). Kampionet që regjistrojnë vlera PI > 50% vlerësohen si negative. Kampionet që regjistrojnë vlera PI mbi dhe poshtë kufirit për pusetat dublikate konsiderohen të dyshimta; kampione të tilla mund të ritestohen me testin e pikave dhe/ose të titrimit. Edhe kampionet pozitive mund të titrohen për të siguruar një të dhënë mbi shkallën e pozitivitetit.

Leximi me sy të lirë: Kampionet pozitive dhe negative dallohen lehtësisht me sy; kampionet pozitive të dobëta ose negative të forta mund të jenë më të vështirë për t'u interpretuar vetëm me sy të lirë.

4. A.6. Përgatitja e antigjenit BTV për testimin me ELISA:

1. Lahen tri herë 40-60 pllaka Ru (roux) me qeliza konfluente BHK-21 me terren Eagle pa serum dhe infektohen me virusin e "Gjuhës blu" serotipi 1 në terren Eagle pa serum.

2. Inkubohen pllakat në 37°C dhe ekzaminohen çdo ditë për efekt citopatik (CPE).

3. Kur efekti citopatik të ketë përfshirë 90 deri 100 % të shtresës qelizore në çdo pllakë Ru, mblidhet virusi duke shkundur ndonjë qelizë të ngjitur te xhami.

4. Centrifugohen me 2.000 deri 3.000 rrotullime/minutë për të mbledhur qelizat.

5. Derdhet supernatantin dhe rishpërndahen qelizat në afërsisht 30 ml PBS që përmban 1% "Sarkosyl" dhe 2 ml fenilmetilsulfonil fluorid (bufer lizues). Kjo mund të bëjë që qelizat të formojnë një xhel, prandaj për të zvogëluar këtë efekt mund të shtohet më shumë bufer lizues (kujdes: fenilmetilsulfonil fluoridi është i rrezikshëm – mbajeni me kujdesin më të madh).

6. Qelizat prishen duke përdorur një sondë ultrasonike për 60 sekonda me një amplitudë 30 mikron.

7. Centrifugohen me 10.000 rrotullime për 10 minuta.

8. Ruhet supernatanti në + 4°C dhe rishpërndahen qelizat e mbetura në 10 - 20 ml bufer lizues.

9. Sonifikohet dhe qartësohet, duke ruajtur supernatantin në çdo stad, për një total prej tri herësh.

10. Mblidhen supernatantët dhe centrifugohen me 24.000 rrotullime/ minutë (100.000 xhiro) për 120 minuta në + 4°C të mbrojtur me 5 ml solucion sukroze 40% (peshë/vëllim në PBS), duke përdorur tuba centrifuge 30 ml Beckmann dhe një rotor SW 28.

11. Derdhet supernatanti, thahen tubat dhe rishpërndahet mbetja në PBS nëpërmjet sonifikimit. Antigjeni ruhet në ampula të vogla në – 20°C.

4. A.7. Titrimi i antigjenit BTV ELISA:

Antigjeni i "Gjuhës blu" për ELISA titrohet nëpërmjet testit ELISA indirekte. Hollimet dyfishe të antigjenit titrohen kundrejt një hollimi konstant (1/100) të antitrupave monoklonalë 3-17-A3. Protokolli është si më poshtë:

1. Titrohet një hollim 1:20 i antigjenit BTV në PBS në një pllakë mikrotitrimi në një seri hollimi dyfishe (50 µl/pusetë) duke përdorur një pipetë me shumë kanale.

2. Inkubohet për një orë në 37°C në një tundës që rrotullohet.

3. Shpëlahen pllakat tri herë me PBS.

4. Shtohen 50 µl antitrup monoklonal 3-17-A3 (holluar 1/100) në çdo pusetë të pllakës së mikrotitrimit.

5. Inkubohet për një orë në 37°C në një tundës që rrotullohet.

6. Shpëlahen pllakat tri herë me PBS.

7. Shtohen 50 µl imunoglobulinë antimi prodhuar në lepuj të markuar me peroksidazë, të holluar në një përqendrim optimal të paratitruar, në çdo pusetë të pllakës së mikrotitrimit.

8. Inkubohet për një orë në 37°C në një tundës që rrotullohet.

9. Shtohet substrati dhe kromogjeni siç u përshkrua më sipër. Ndalohet reaksioni pas 10 minutash duke shtuar acid sulfurik 1 Molar (50 µl/pusetë).

Në provën konkurruese, antitrupi monoklonal duhet të jetë me tepricë, pra është zgjedhur një hollim i antigjenit që të jetë brenda kurbës së titrimit (jo në rajonin e sheshtë) i cili të japë afërsisht 0,8 OD pas 10 minutash.

4.B. Testi i imunodifuzionit në agar-xhel duhet të kryhet në pajtim me protokollin e mëposhtëm:

4.B.1. Antigjeni:

Antigjeni precipitues përgatitet në çdo kulturë qelizore që mbështet shumëzimin e shpejtë të një shtami reference të virusit të "Gjuhës blu". Rekomandohen linjat qelizore BHK ose Vero. Antigjeni është i pranishëm në lëngun supernatant në fund të rritjes së virusit, por kërkon një përqendrim 50 deri 100 herë, në mënyrë që të jetë efektiv. Kjo mund të arrihet nga çdo procedurë standarde e përqendrimit të proteinave; virusi në antigjen mund të inaktivohet nga shtimi i 0,3 % (v/v) beta-propiolakton.

4.B.2. Serumet e njohur pozitive dhe negative:

Serumi standard kombëtar prodhohet duke përdorur antigjenin dhe serumin e referencës ndërkombëtare, që standardizohet për proporcionin optimal kundrejt serumit të referencës ndërkombëtare, ruhet i liofilizuar dhe përdoret si serum i njohur kontrolli në çdo test.

4.B.3. Serumet që testohen:

Procedura: Procedura: Agaroza 1% e përgatitur në borat ose bufer sodium barbitol, pH 8,5 - 9,0, hidhet në një pjatë petri me një thellësi minimale 3.0 mm. Një format testi me shtatë puseta, secila prej tyre me diametër 5.0 mm, pritet në agar. Formati përbëhet nga një pusetë qendrore dhe 6 puseta rrotull saj në formën e një rrethi me rreze 3 cm. Puseta qendrore mbushet me antigjenin standard. Pusetat periferike 2, 4 dhe 6 mbushen me serum të njohur pozitiv, pusetat 1, 3 dhe 5 mbushen me serumet që testohen. Sistemi inkubohet për 72 orë në temperaturë dhome në një dhomë të mbyllur me lagështirë.

Interpretimi: Një serum që testohet është pozitiv nëse ai formon një vijë specifike precipitimi me antigjenin dhe formon një vijë të plotë të ngjashme me serumin e kontrollit. Një serum që testohet është negativ nëse ai nuk formon një vijë specifike me antigjenin dhe nuk përkul vijën e serumit të kontrollit. Pllakat e Petrit mund të ekzaminohen kundrejt një sfondi të errët dhe duke përdorur një ndriçim indirekt.

5. SËMUNDJA E HEMORRAGJISË EPIZOOTIKE (EHD)

5.A. Testi i imunodifuzionit në agar-xhel (AGID) duhet të kryhet sipas protokollit të mëposhtëm:

5.A.1. Antigjeni:

Antigjeni precipitues përgatitet në çdo sistem të kulturës qelizore që mbështet shumëzimin e shpejtë të serotipit të përshtatshëm të virusit të sëmundjes epizootike hemoragjike. Rekomandohen qelizat BHK ose Vero. Antigjeni është i pranishëm në lëngun supernatant në fund të rritjes së virusit, por kërkon një përqendrim 50 deri 100 herë, në mënyrë që të jetë efektiv. Kjo mund të arrihet nga çdo procedurë standarde e përqendrimit të proteinave; virusi në antigjen mund të inaktivohet nga shtimi i 0,3 % (v/v) beta-propiolakton.

5.A.2. Serumet e njohura pozitive dhe negative:

Serumi standard kombëtar prodhohet duke përdorur antigjenin dhe serumin e referencës ndërkombëtare, që standardizohet për proporcionin optimal kundrejt serumit të referencës ndërkombëtare, ruhet i liofilizuar dhe përdoret si serum i njohur kontrolli në çdo test.

5.A.3. Serumet që testohen:

Procedura: Agaroza 1% e përgatitur në borat ose bufer sodium barbitol, pH 8,5 - 9,0, hidhet në një pjatë petri me një thellësi minimale 3.0 mm. Një format testi me shtatë puseta, secila prej tyre me diametër 5.0 mm, pritet në agar. Formati përbëhet nga një pusetë qendrore dhe 6 puseta rrotull saj në formën e një rrethi me rreze 3 cm. Puseta qendrore mbushet me antigjenin standard. Pusetat periferike 2, 4 dhe 6 mbushen me serum të njohur pozitiv, pusetat 1, 3 dhe 5 mbushen me serumet që testohen. Sistemi inkubohet për 72 orë në temperaturë dhome në një dhomë të mbyllur me lagështirë.

Interpretimi: Një serum që testohet është pozitiv nëse ai formon një vijë specifike precipitimi me antigjenin dhe formon një vijë të plotë të ngjashme me serumin e kontrollit. Një serum që testohet është negativ nëse ai nuk formon një vijë specifike me antigjenin dhe nuk përkul vijën e serumit të kontrollit. Pllakat e Petrit mund të ekzaminohen kundrejt një sfondi të errët dhe duke përdorur një ndriçim indirekt.

6. RINOTRAKEITI INFEKTIV I GJEDHIT (IBR)/VULVO - VAGINITI INFEKTIV PUSTULAR (IPV)

6.A. Testi i neutralizimit të serumit do të kryhet sipas protokollit të mëposhtëm:

6.A.1. Serumet: Të gjitha serumet inaktivohen me ngrohje në 56°C për 30 minuta para përdorimit.

Procedura: testi i neutralizimit të serumit të virusit që ndryshon në vijimësi (constant virus-varying) në pjata mikrotitrimi përdor qeliza MDBK ose qelizat e tjera të ndjeshme. Shtamet virale Kolorado, Oxford apo ndonjë shtami tjetër të referencës përdoret në 100 TCID50 për 0.025 ml; kampionet e inaktivuara të paholluara të serumit përzihen me një vëllim të barabartë (0.025 ml) të suspensionit viral. Përzierjet virus/serum inkubohen për 24 orë në 37°C në pllaka

mikrotitrimi përpara se të shtohen qelizat MDBK. Qelizat përdoren në një përqendrim që formon një monoshtresë të plotë pas 24 orësh.

6.A.2. Kontrollet:

i) prova e infektivitetit të virusit,

ii) kontrolli i toksicitetit të serumeve,

ii) kontrolli i kulturave qelizore të painokuluara,

iv) antiserumet e referencës.

6.A.3. Interpretimi: Rezultatet e testit te neutralizimit dhe titrimit të virusit të përdorura në provë regjistrohen pas tri deri në gjashtë ditë të inkubimit në 37°C. Serumet e titruara konsiderohen negative nëse nuk ka neutralizimin në një hollim 1/2 (serum i paholluar).

7. AFTA EPIZOOTIKE (FOOT AND MOUTH DISEASE – FMD)

7.A. Mbledhja e kampioneve esofaringeale/faringeale dhe testimi duhet të kryhet sipas protokollit të mëposhtëm:

7.A.1. Reagente: Para marrjes së kampioneve, përgatitet terreni i transportit. Dy vëllime nga 2 ml shpërndahen në aq kontejnerë sa është numri i kafshë që duhet të kampionohen. Kontejnerët e përdorur duhet t'i përballojnë ngrirjes ne CO_2 të ngurtë apo azotit të lëngshëm. Kampionet merren duke përdorur një aparat të projektuar posaçërisht për të mbledhur pështymë të quajtur *probang*. Për të marrë një kampion, aparati *probang* kalohet nëpër gojë, mbi dorsumin e gjuhës dhe poshtë në pjesën e sipërme të ezofagut. Gjatë marrjes së kampionit duhet të bëhen përpjekje për të gërvishtur epitelin e sipërfaqes së sipërme të ezofagut dhe fytit nga lëvizjet e drejtuara anash dhe dorsalisht. *Probang* pastaj tërhiqet, nëse është e mundur pasi kafsha ka gëlltitur. Kupa duhet të jetë e plotë dhe të përmbajë një përzierje të mukozës, pështymës, lëngut ezofagal dhe mbeturinat qelizore. Duhet bërë kujdes për të siguruar që çdo mostër përmban disa materiale të dukshme qelizore. Duhet të shmanget trajtimi i ashpër që shumë shpesh shkakton gjakderdhje. Kampionet nga disa kafshë mund të jetë shumë të kontaminuar. Në një rast të tillë kampioni duhet të hidhet tutje dhe para rimarrjes së kampionit, gryka e kafshëve shpëlahet me ujë, ose më mirë me ujë fiziologjik.

7.A.2. Trajtimi i kampionëve: Çdo kampion i mbledhur në *probang* duhet parë për cilësinë dhe 2 ml prej secilit kampion shtohen në 2 ml të terrenit të transportit (në vëllim të barabartë) në një enë me qëllim që të mund të përballojë ngrirjen.

Kontejnerët duhet të jenë të mbyllur fort, dezinfektuar dhe etiketuar. Kampionet duhet te mbahen ne ambient të freskët (+ 4°C) dhe të ekzaminohen brenda 3-4 orëve ose të vendosen mbi akull të thatë (-69°C) apo azot të lëngshëm dhe të mbahen të ngrira deri sa te ekzaminohen. Pas përdorimit tek një kafshë, *probang*-u dezinfektohet dhe shpëlahet 3 herë me ujë të pastër, përpara se të përdoret sërish në një kafshë tjetër.

7.A.3. Testimi për virusin e "Aftës epizootike": Kampionet inokulohen në kulturat e kulturave primare qelizore të tiroideve të gjedhit duke përdorur të paktën tri tuba për një kampion. Mund të përdoren edhe qelizat e tjera të ndjeshme, të tilla si qelizat primare të veshkave të gjedhit apo derrit, por duhet pasur parasysh se për disa shtame të virusit të Aftës ato janë më pak të ndjeshme. Tubat inkubohen në 37°C në një aparat që rrotullohet dhe ekzaminohen çdo ditë për 48 orë për praninë e një efekti citopatik (CPE). Nëse është negative, kulturave u bëhet një pasazh i "verbër" mbi kultura të reja dhe rishqyrtohet për 48 orë. Specificiteti i çdo CPE duhet të konfirmohet.

7.A.4. Terreni transportues i rekomanduar:

1. 0,08 tampon M fosfat pH 7,2 që përmban 0,01% albumin të serumit të gjedhit, 0,002% fenol të kuq dhe antibiotikë.

2. Terreni i kulturave indore (të tilla si MEM Eagle) që përmban 0,04 M tampon Hepes, 0,01% e albumin së serum të gjedhit dhe antibiotikët, pH 7,2.

3. Në terrenin e transportit duhet të shtohen antibiotikë të tillë si penicilinë 1.000 IU/ml (unitete), neomicin sulfat 100 IU/ml, polimiksinë B sulfat 50 IU/ml, mykostatin 100 IU/ml.

7. B. Testi i neutralizimit të virusit duhet të kryhet sipas protokollit të mëposhtëm:

7.B.1. Reagentët: Antigjeni i materialit viral të Aftës rritet në monoshtresë të kulturave qelizore ose në gjuhën e gjedhit dhe ruhet në temperaturë -70°C ose më pak ose në –20°C pas shtimit të 50% glicerol. Kjo është rezerva e antigjenit. Virusi i Aftës është i qëndrueshëm në këto kushte dhe titrat mund të ndryshojnë shumë pak gjatë një periudhe disamujore.

7.B.2. Procedura: Testi kryhet në pllaka mikrotitrimi me fund të sheshtë për kulturat indore duke përdorur qeliza të ndjeshme të tilla si IB-RS-2, BHK-21 ose qeliza të veshkave të viçit. Serumet për këto teste hollohen 1/4 në terren me serum pa kultura qelizore të cilit i shtohen neomicinë 100 IU/ml ose antibiotikë të tjerë të përshtatshëm. Serumet inaktivohen në 56°C për 30 minuta dhe sasi prej 50 μl përdoren për të përgatitur serinë dyfishe të hollimit në pllakën e mikrotitrimit.

Shtohet virusi i titruar paraprakisht në terrenin me serum pa kultura qelizore që përmban 100 TCID50, pastaj 50 μl hidhen në secilën pusetë. Pas inkubimit në 37°C për 1 orë që lejon zhvillimin e neutralizmit, në secilën pusetë shtohen 50 μl nga suspensioni i qelizave që përmban 0,5 në 1.0 × 106 qeliza/ml të terrenit me serum pa antitrupa kundër Aftës dhe pastaj pllakat mbulohen me shirit.

Pllakat inkubohen në 37°C. Monoshtresat zakonisht janë të bashkuara brenda 24 orëve. Efekti citopatik (CPE) në 48 orë është i zhvilluar mjaftueshëm për një test të leximit në mikroskop. Në këtë kohë mund të kryhet një lexim përfundimtar në mikroskop ose pllakat mund të fiksohen për lexim makroskopik, duke përdorur për shembull 10% kripë formoli dhe 0,05% blu metilen.

7.B.3. Kontrollet: Kontrollet në çdo test përfshijnë një antiserum standard me titër të njohur, një kontroll të qelizave, një kontroll të toksicitetit të serumit (serum negativ), një kontroll të terrenit, dhe një titrim i virusit i përdorur për të llogaritur titrin aktual të virusit të përdorur në test.

7.B.4. Interpretimi: Pusetat që shfaqin efekt citopatik (CPE) konsiderohen si të infektuara dhe titrat e neutralizimit shprehen si invers i hollimit përfundimtar të serumit të pranishëm në përzierjet serum/virus në 50% të pikës së fundit të përllogaritur sipas metodës Spearman-Karber (Karber, G., 1931, Archiv fuer Experimentelle Pathologie und Pharmokologie, 162, 480). Testet konsiderohen të jenë të vlefshme kur shuma aktuale e virusit të përdorur në pusete në testim është në mes 101,5 dhe 102,5 të TCID50 dhe kur titri i serumit të referencës është brenda dyfishit të titrit të pritshëm të saj, të vlerësuar nga mënyra e mëparshme e titrimeve. Kur kontrollet janë jashtë këtyre kufijve testet duhet të përsëriten. Një titër i pikës së fundit 1/11 ose më pak konsiderohet si negativ.

7.C. Zbulimi dhe vlerësimi i antitrupave nga testi ELISA duhet të kryhet sipas protokollit të mëposhtëm:

7.C.1. Reagentët: Antiserumi i lepurit ndaj antigjenit 146S të 7 tipave të virusit të Aftës përdoret si antitrup kapës në një përqendrim optimal të paracaktuar në karbonat/bikarbonat buferik, pH 9,6. Antigjenët përgatiten nga shtame të zgjedhur të virusit të Aftës të rritur në monoshtresën e qelizave BHK-21. Supernatantët e papurifikuar përdoren dhe paratitrohen sipas protokollit, por pa serum. Hollimi final i zgjedhur është ai i cili, pas shtimit të një volumi të barabartë të holluesit PBST (phosphate buffered saline që përmban 0,05 % Tween 20 dhe indikator fenol i kuq) jep një densitet optik ndërmjet 1,2 dhe 1,5. Viruset mund të përdoren të inaktivuar. PBST përdoret si hollues.

Antiserumet e kavjeve përgatiten duke inokuluar kavjet me antigjen 146S të secilit serotip. Përqendrimi optimal i paracaktuar përgatitet në PBST që përmban 10% serum normal gjedhi dhe 5% serum normal lepuri. Imunoglobulina antikavje e lepujve e konjuguar me horseradish peroxidase përdoret në një përqendrim optimal të paracaktuar në PBST që përmban 10% serum normal gjedhi dhe 5% serum normal lepuri. Serumet që testohen hollohen në PBST.

7.C.2. Procedura:

1. Pllakat ELISA vishen me 50 μl/pusetë serum antiviral lepuri dhe lihen për një natë në një dhomë me lagështi në temperaturën e dhomës.

2. Në pllaka mikrotitrimi me fund U (pllaka carrier) përgatiten nga 50 μl në dublikatë seri hollimi dyfishe të çdo serumi që testohet, duke filluar nga 1/4. Në çdo pusetë shtohen 50 μl të një doze konstante të antigjenit viral dhe përzierjet lihen gjithë natën në 4ºC. Shtimi i antigjenit rrit hollimin fillestar të serumit në 1/8.

3. Pllakat ELISA lahen 5 herë me PBST.

4. Më pas, 50 μl të përzierjes serum/antigjen transferohen nga pllaka *carrier* në pllakat ELISA të veshura me serum lepuri dhe inkubohen në 37ºC për 1 orë në një përzierës rrotullues.

5. Pas larjes së pllakave, në çdo pusetë shtohen 50 μl të përzierjes antiserum antikavje në antigjen të përdorur sipas pikës 4. Pllakat inkubohen në 37ºC për 1 orë në një përzierës rrotullues.

6. Pllakat lahen dhe në çdo pusetë shtohen nga 50 μl të imunoglobulinës së lepurit antikavje të konjuguar me horseradish peroxidase. Pllakat inkubohen në 37ºC për 1 orë në një përzierës rrotullues.

7. Pllakat lahen sërish dhe në çdo pusetë shtohen nga 50 μl të orthophenylene diamine që përmban 0,05% H2O2 (30%, p/v).

8. Reaksioni ndalohet pas 15 minutash duke shtuar acidit sulfuric 1,25 M. Pllakat lexohen në një spektrofotometër në 492 nm të lidhur me një kompjuter.

Kontrollet: Për secilin antigjen të përdorur, 40 puseta nuk përmbajnë serum, por përmbajnë antigjen të holluar në PBST. Një seri dyshe e hollimeve dyfishe të antiserumit të gjedhit homolog i antiserumit të referencës. Një seri dyshe e hollimeve dyfishe të serumit negativ të gjedhit.

Interpretimi i rezultateve: Titrat e antitrupave shprehen si titra të hollimit përfundimtar të kampionit të serumit që jep 50% të vlerës mesatare të OD (densitetit optic) të regjistruar në pusetat e kontrollit të virusit ku mungon serumi që testohet. Titrat më të mëdhenj se 1:40 konsiderohen si pozitive.

Referencat: Hamblin C, Barnett ITR and Hedger RS (1986) "A new enzyme-linked immunosorbent assay (ELISA) for the detection of antibodies against foot-and-mouth disease virus. I. Development and method of ELISA". *Journal of Immunological Methods, 93, 115 to 121.11.*

8. PSEUDOTËRBIMI (SËMUNDJA E AUJESKIT)

8.A. Testi i neutralizimit të serumit duhet të kryhet sipas protokollit të mëposhtëm:

8.A.1. Serumi: Të gjitha serumet inaktivohen me anë të ngrohjes në 56°C për 30 minuta para përdorimit.

8.A.2. Procedura: Testi i neutralizimit të serumit të virusit që ndryshon në vijimësi (constant virus-varying) në pjata mikrotitrimi përdor linjën qelizore Vero apo sisteme të tjera të ndjeshme qelizore. Virusi i sëmundjes Aujeskit përdoret në 100 TCID50 për 0.025 ml; kampionet e serumeve inaktive të paholluara përzihen me një vëllim të barabartë (0.025 ml) të suspensionit viral. Përzierjet virus/serum inkubohen për dy orë në 37°C në pllaka mikrotitrimi përpara se të shtohen qelizat e duhura. Qelizat përdoren në një përqendrim i cili formon një monoshtrese të plotë pas 24 orësh.

8.A.3. Kontrollet: i) prova e infektivitetit të virusit; ii) kontrolli i toksicitetit te serumit; iii) kontrollet e kulturave qelizore të painokuluara; iv) antiserumet e referencës.

8.A.4. Interpretimi: Rezultatet e testit të neutralizimit dhe titri i virusit të përdorur në provë regjistrohen pas 3-7 ditësh inkubimi në 37°C. Titrat e serumeve më pak se 1/2 (serum i paholluara) konsiderohen si negative.

9. GASTRO-ENTERITI I TRANSMETUESHËM (TGE)

9.A. Testi i neutralizimit të serumit duhet të kryhet sipas protokollit të mëposhtëm:

9.A.1. Serumi: Të gjitha serumet inaktivohen me anë të ngrohjes në 56°C për 30 minuta

para përdorimit.

9.A.2. Procedura: Testi i neutralizimit të serumit të virusit që ndryshon në vijimësi (constant virus-varying) në pjata mikrotitrimi përdor qelizat A72 (qeliza tumorale të qenit) apo sisteme të tjera të ndjeshme qelizore. Virusi shkaktar i TGE përdoret në 100 TCID50 për 0.025 ml; kampionet e serumeve inaktive të paholluara përzien me një vëllim të barabartë (0.025 ml) të suspensionit viral. Përzierjet virus/serum inkubohen për 30 deri 60 minuta në 37°C në pllaka mikrotitrimi përpara se të shtohen qelizat e duhura. Qelizat përdoren në një përqendrim i cili formon një monoshtrese të plotë pas 24 orësh. Çdo qelizë merr 0.1 ml suspension qelizor.

9.A.3. Kontrollet: i) prova e infektivitetit të virusit; ii) kontrolli i toksicitetit të serumit, iii) kontrollet e kulturave qelizore të painokuluara, iv) antiserumet e referencës.

9.A.4. Interpretimi: Rezultatet e testit të neutralizimit dhe titri i virusit të përdorur në provë regjistrohen pas 3-7 ditësh inkubimi në 37°C. Titrat e serumeve më pak se 1/2 (hollimi final) konsiderohen negative. Nëse serumet e paholluara janë toksike për kulturat qelizore, këto serume mund të hollohen me 1/2 përpara se të përdoren në test. Kjo është e barasvlershme me 1/4 e hollimit final të serumit. Titrat e serumit më pak se 1/4 (hollimi final) në këto raste konsiderohen negative

10. SËMUNDJA VEZIKULARE E DERRAVE (SVD)

Testet për sëmundjen vezikulare të derrave duhet të kryhen në përputhje me vendimin 2000/428/EC (OJ L 167, 7.7.2000, p. 22).

11. MURTAJA KLASIKE E DERRAVE – MKD (CSF)

Testet për murtajën klasike të derrave duhet të kryhen në përputhje me manualin e miratuar me urdhërmanualin e miratuar me urdhër të ministrit nr.404, datë 15.11.2007.

Kryerja e testeve për murtajën klasike të derrave duhet të ndjekë udhëzimet e përcaktuara në kapitullin përkatës të manualit të OIE për testet diagnostike dhe vaksinat e kafshëve të tokës.

Vlerësimi i ndjeshmërisë dhe specificitetit të testit serologjik për MKD duhet të kryhet në laboratorin e qendrës kombëtare të referencës, që zbaton procedurat e sigurimit të cilësisë. Testet e përdorura duhet të jenë në gjendje të dallojnë serumet e dobëta dhe të forta pozitive të referencës dhe të lejojnë zbulimin e antitrupave si në fazën e hershme të infeksionit ashtu dhe gjatë shërimit

KAPITULLI 2
TESTET PËR SHËNDETIN E KAFSHËVE

1. KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Kafshët duhet t'u nënshtrohen testeve të mëposhtme që kryhen mbi kampionet e gjakut të marra, në qoftë se nuk kërkohet ndryshe, jo më përpara se 21 ditë nga data e fillimit të periudhës së izolimit

Testet laboratorike duhet të kryhen në një laborator të miratuar nga autoriteti kompetent veterinar i vendit eksportues dhe të gjitha testet laboratorike dhe rezultatet e tyre, vaksinimet dhe trajtimet duhet të shoqërojnë (mbyllen) certifikatën shëndetësore.

Në mënyrë që të ulen në minimum ndërhyrjet në kafshë, marrja e kampioneve, testet dhe ndonjë vaksinim duhet të grupohen sa të jetë e mundur duke respektuar ndërkohë intervalet minimale të kohës së kërkuar nga protokollet e testimit të përcaktuara në pjesën 2 të këtij kapitulli.

2. KËRKESA TË VEÇANTA

2.1 *CAMELIDAE*

2.1.1 Tuberkulozi (TBC)

a) Testet që përdoren:

Testi krahasues i reaksionit intradermal me përdorimin e derivatit proteinik të purifikuar të gjedhit *(bovine PPD)* dhe të shpendëve *(avian PPD)* në përputhje me standardet për prodhimin e tuberkulinës së gjedhit dhe asaj aviare siç përshkruhet në pikën 2.1.2 të shtojcës B të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit nr.255, datë 10.6.2008 "Mbi problemet e shëndetit të kafshëve të llojeve gjedh dhe derra".

Testi duhet kryer në zonën prapa shpatullës (rajoni aksilar) sipas metodës së përshkruar në pikën 2.2.4 të shtojcës B të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit nr.255, datë 10.6.2008 "Mbi problemet e shëndetit të kafshëve të llojeve gjedh dhe derra".

b) Koha:

Kafshët duhen testuar brenda 2 ditëve nga data e mbërritjes në stacionin e karantinës dhe 42 ditë nga data e testimit të parë.

c) Interpretimi i testeve:

Reaksioni do të konsiderohet:

- Negativ në qoftë se rritja e trashësisë së lëkurës është më pak se 2 mm.
- Pozitiv në qoftë se rritja e trashësisë së lëkurës është më shumë se 4 mm.
- Jopërfundimtar/jobindës në qoftë se rritja e trashësisë së lëkurës me PPD e gjedhit është ndërmjet 2 mm dhe 4 mm, ose më shumë se 4 mm por më pak sesa reaksioni ndaj PPD aviare.

d) Mundësitë për veprim pas testimit:

Nëse një kafshë jep një rezultat pozitiv në reaksionin intradermal me PPD e gjedhit, ajo kafshë duhet hequr nga grupi dhe kafshët e tjera duhet të ritestohen duke filluar të paktën 42 ditë nga data e kryerjes së testit të parë pozitiv dhe kjo konsiderohet si testi i parë i përshkruar në pikën (b).

Nëse më shumë se një kafshë nga grupi jep rezultat pozitiv, i gjithë grupi të mos pranohet për të hyrë në Republikën e Shqipërisë.

Nëse një ose më shumë kafshë të të njëjtit grup japin një rezultat jobindës, i gjithë grupi duhet të ritestohet duke filluar të paktën 42 ditë nga data e kryerjes së testit të parë pozitiv dhe kjo konsiderohet si testi i parë i përshkruar në pikën (b).

2.1.2 Bruceloza

a) Testet që përdoren:

i) *Brucella abortus*: Testi Rose Bengal (RBT) dhe testi i aglutinimit të serumit (SAT), siç përshkruhen përkatësisht në pikat 2.5 dhe 2.6 të shtojcës C të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit nr.255, datë 10.6.2008 "Mbi problemet e shëndetit të kafshëve të llojeve gjedh dhe derra". Në rast të një rezultati pozitiv do të kryhet testi i lidhjes së komplementit (CFT) siç përshkruhet në pjesën 6 të shtojcës I të kësaj rregulloreje.

ii) *Brucella abortus*: Testi Rose Bengal (RBT) dhe testi i aglutinimit të serumit (SAT), siç përshkruhen përkatësisht në pikat 2.5 dhe 2.6 të shtojcës C të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit nr.255, datë 10.6.2008 "Mbi problemet e shëndetit të kafshëve të llojeve gjedh dhe derra". Në rast të një rezultati pozitiv do të kryhet testi i lidhjes së komplementit (CFT), siç përshkruhet në pjesën 6 të shtojcës I të kësaj rregulloreje.

iii) *Brucella melitensis*: RBT dhe SAT, siç përshkruhen përkatësisht në pikat 2.5 dhe 2.6 të shtojcës C të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit nr.255, datë 10.6.2008 "Mbi problemet e shëndetit të kafshëve të llojeve gjedh dhe derra".

iv) Në rast të një rezultati pozitiv, do të kryhet testi i lidhjes së komplementit (CFT), siç përshkruhet në shtojcën C të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit nr.187, datë 11.6.2009 "Mbi rregullat e shëndetit të kafshëve në tregtinë e të imtave".

v) *Brucella ovis*: Testi i lidhjes së komplementit (CFT) siç përshkruhet në shtojcën D të

rregullores së miratuar me urdhër të ministrit nr.187, datë 11.6.2009 "Mbi rregullat e shëndetit të kafshëve në tr

b) Koha: kafshët duhen testuar brenda 2 ditëve nga data e mbërritjes në stacionin e karantinës dhe 42 ditë nga data e testimit të parë.

c) Interpretimi i testeve:

Rastet kur një reaksioni konsiderohet si pozitiv përcaktohen në shtojcën C të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit nr.255, datë 10.6.2008 "Mbi problemet e shëndetit të kafshëve të llojeve gjedh dhe derra".

d) Mundësitë për veprim pas testimit:

Kafshët që kanë rezultuar pozitive me një nga testet do të hiqen nga grupi dhe kafshët e tjera do të ritestohen duke filluar të paktën 42 ditë nga data e kryerjes së testit të parë pozitiv dhe kjo konsiderohet si testi i parë i përshkruar në pikën (b).

Vetëm kafshët që rezultojnë negative ndaj 2 testeve të njëpasnjëshme të kryera sipas përshkrimit në pikën (b) lejohen të hyjnë në Republikën e Shqipërisë.

2.1.3 Gjuha Blu dhe sëmundja epizootike hemorragjike (EHD)

a) Testet që përdoren: testi i imunodifuzionit në agar-xhel (AGID) siç përshkruhet në pjesën 6 të shtojcës I të kësaj rregulloreje.

Në rast të një reaksioni pozitiv kafshët do të testohen me testin ELISA konkurrues siç përshkruhet në pjesën 6 të shtojcës I të kësaj rregulloreje për të bërë dallimin mes 2 sëmundjeve.

b) Koha: Testimi i kafshëve duhet të japë rezultat negativ në 2 teste: i pari brenda 2 ditëve nga data e mbërritjes së tyre në stacionin e karantinës dhe i dyti të paktën 21 ditë nga data e testimit të parë.

c) Mundësitë për veprim pas testimit:

i) Gjuha Blu

Nëse një ose më shumë kafshë rezultojnë pozitive në testin ELISA siç përshkruhet në pjesën 6 të shtojcës I të kësaj Rregulloreje, kafsha/ët pozitive duhet të hiqen nga grupi dhe të gjitha kafshët e mbetura të grupit duhet të vendosen në karantinë për 100 ditë duke filluar nga data në të cilën u morën kampionet që dhanë rezultat pozitiv. Grupi do të konsiderohet i pastër nga sëmundja e "Gjuhës blu" nëse gjatë kontrolleve të rregullta të kryera nga veterinerët zyrtarë gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës së karantinës nuk zbulohen simptoma klinike të sëmundjes dhe stacioni i karantinës mbetet i pastër nga vektorët e sëmundjes së "Gjuhës blu" (*kulikoidet*).

Nëse një kafshë tjetër shfaq simptoma klinike të sëmundjes së "Gjuhës blu" gjatë periudhës së karantinës siç përshkruhet në nënparagrafin e parë, të gjitha kafshët e grupit nuk do të lejohen për të hyrë në Republikën e Shqipërisë.

ii) Sëmundja epizootike hemorragjike (EHD)

Nëse një ose më shumë kafshë të testuara pozitive zbulojnë praninë e antitrupave të virusit të EHD gjatë testimit konfirmues në ELISA, kafsha/ët do të konsiderohen pozitive dhe hiqen nga grupi, dhe i gjithë grupi do t'i nënshtrohet testimit përsëritës duke filluar të paktën 21 ditë pas datës së diagnozës së parë pozitive dhe sërish 21 ditë nga data e përsëritjes së testit, të dyja me rezultate negative.

Nëse ndonjë kafshë tjetër rezulton pozitive gjatë ose njërit ose të dy testeve përsëritëse, i gjithë grupi i kafshëve nuk do të lejohet të hyjë në Republikën e Shqipërisë.

2.1.4 Sëmundja e " Aftës epizootike" (FMD)

a) Testet që përdoren: Testet diagnostike (probang dhe serologji) duke përdorur teknikat ELISA dhe të neutralizimit të virusit (VN) në përputhje me protokollet e përshkruar në pjesën 6 të shtojcës I të kësaj rregulloreje.

b) Koha: kafshët duhet të japin rezultate negative në 2 teste: testimi i parë 2 ditë nga data e mbërritjes së tyre në stacionin e karantinës dhe i dyti të paktën 42 ditë nga data e testimit të parë.

c) Mundësitë për veprim pas testimit: Nëse ndonjë kafshë rezulton pozitiv për virusin e Aftës, atëherë asnjë prej kafshëve të pranishme në stacionit të karantinës nuk do të lejohet të hyjë në Republikën e Shqipërisë.

Shënim. Çdo zbulim i antitrupave të proteinave strukturore ose jostrukturore të virusit të Aftës do të konsiderohet si një rezultat i një infeksioni të mëparshëm të "Aftës epizootike" pavarësisht nga statusi i vaksinimit.

2.1.5 Murtaja e gjedhit (Rinderpest)

a) Testet që përdoren: Testi ELISA konkurrues siç përshkruhet në Manualin e OIE të testeve diagnostike dhe vaksinave të kafshëve të tokës, versioni më i fundit, është testi i parashikuar për tregtinë ndërkombëtare dhe është testi i zgjedhur.

Gjithashtu mund të përdoren edhe testi i neutralizimit të serumit ose teste të tjera të njohura në përputhje me protokollet e përshkruara në pjesët përkatëse të manualit të OIE.

b) Koha: kafshët duhen testuar dy herë: testimi i parë brenda 2 ditëve nga data e mbërritjes së tyre në stacionin e karantinës dhe i dyti të paktën 42 ditë nga data e testimit të parë.

c) Mundësitë për veprim pas testimit: Nëse ndonjë kafshë rezulton pozitiv në testin për virusin e murtajës së gjedhit, asnjë prej kafshëve të pranishme në stacionin e karantinës nuk do të lejohet të hyjë në Republikën e Shqipërisë.

2.1.6 Stomatiti vezikular

a) Testet që përdoren: ELISA, testi i neutralizimit të virusit ose teste të tjera të njohura në përputhje me protokollet e përshkruara në seksionet përkatëse të manualit të OIE.

b) Koha: kafshët do të testohen 2 herë: testimi i parë brenda 2 ditëve nga mbërritja në stacionin e karantinës dhe i dyti të paktën 42 ditë nga data e testimit të parë.

c) Mundësitë për veprim pas testimit: Nëse një kafshë rezulton pozitive për "Stomatitin vezikular", asnjë nga kafshët e pranishme në stacionin e karantinës nuk do të lejohet të hyjë në Republikën e Shqipërisë.

2.1.7 Ethja e luginës Rift (Rift valley fever)

a) Testet që përdoren: ELISA, testi i neutralizimit të virusit ose teste të tjera të njohura në përputhje me protokollet e përshkruara në seksionet përkatëse të manualit të OIE.

b) Koha: kafshët do të testohen 2 herë: testimi i parë brenda 2 ditëve nga mbërritja në stacionin e karantinës dhe i dyti të paktën 42 ditë nga data e testimit të parë.

c) Mundësitë për veprim pas testimit: Nëse ndonjë nga kafshët shfaq të dhëna të ekspozimit ndaj agjentit shkaktar të sëmundjes, asnjë nga kafshët e pranishme në stacionin e karantinës nuk do të lejohet të hyjë në Republikën e Shqipërisë.

2.1.8 Lija e gjedhit (Lumpy skin disease)

a) Testet që përdoren: ELISA, testi i neutralizimit të virusit ose teste të tjera të njohura në përputhje me protokollet e përshkruara në seksionet përkatëse të manualit të OIE.

b) Koha: kafshët do të testohen 2 herë: testimi i parë brenda 2 ditëve nga mbërritja në stacionin e karantinës dhe i dyti të paktën 42 ditë nga data e testimit të parë.

c) Mundësitë për veprim pas testimit: Nëse ndonjë nga kafshët shfaq të dhëna të ekspozimit ndaj sëmundjes së lisë së gjedhit *(lumpy skin disease)*, asnjë nga kafshët e pranishme në stacionin e karantinës nuk do të lejohet të hyjë në Republikën e Shqipërisë.

2.1.9 Ethja hemorragjike Krime-Kongo (Crimean Congo haemorrhagic fever)

a) Testet që përdoren: ELISA, testi i neutralizimit të virusit, testi i Imunofluoreshencës ose teste të tjera të njohura.

b) Koha: kafshët do të testohen 2 herë: testimi i parë brenda 2 ditëve nga mbërritja në stacionin e karantinës dhe i dyti të paktën 42 ditë nga data e testimit të parë.

c) Mundësitë për veprim pas testimit: Nëse ndonjë nga kafshët shfaq të dhëna të ekspozimit ndaj agjentit shkaktar të ethes hemorragjike Krime-Kongo, asnjë nga kafshët e pranishme në stacionin e karantinës nuk do të lejohet të hyjë në Republikën e Shqipërisë.

2.1.10 *Tripanosomoza (Surra - Trypanosoma evansi)*

a) Testet që përdoren: Agjenti parazitar mund të identifikohet në kampionet e përqendruara të gjakut në përputhje me protokollet e përshkruara në seksionet përkatëse të manualit të OIE.

b)) Koha: kafshët do të testohen 2 herë: testimi i parë brenda 2 ditëve nga mbërritja në stacionin e karantinës dhe i dyti të paktën 42 ditë nga data e testimit të parë.

c) Mundësitë për veprim pas testimit: Nëse *Trypanosoma evansi* zbulohet në ndonjë kafshë në ngarkesë, kjo kafshë nuk lejohet të hyjë në Republikën e Shqipërisë. Kafshët e mbetura të grupit i nënshtrohen trajtimit të brendshëm dhe të jashtëm antiparazitar duke përdorur medikamentet e përshtatshme efektive kundër *T. evansi*.

2.1.11 Ethja katarrale malinje (Malignant catarrhal fever)

a) Testet që përdoren: Zbulimi i ADN virale mbështetur në identifikimin me metoda imunofluoreshente ose imunokimike duke përdorur protokollet e përshkruara në seksionet përkatëse të manualit të OIE.

b) Koha: kafshët do të testohen 2 herë: testimi i parë brenda 2 ditëve nga mbërritja në stacionin e karantinës dhe i dyti të paktën 42 ditë nga data e testimit të parë.

c) Mundësitë për veprim pas testimit: Nëse ndonjë nga kafshët shfaq të dhëna të ekspozimit ndaj Ethes Katarrale Malinje, asnjë prej kafshëve të pranishme në stacionin e karantinës nuk do të lejohet të hyjë në Republikën e Shqipërisë.

2.1.12 Tërbimi

Vaksinimi: Vaksinimi kundër tërbimit mund të kryhet kur kërkohet nga vendi importues (RSH). Në këtë rast një kampion gjaku i kafshës testohet për praninë e antitrupave me testin e neutralizimit të serumit.

2.1.13 Leukoza enzootike e gjedhit (Enzootic bovine leucosis).

(Vetëm në rastet kur kafshët importohen në një territor zyrtarisht të pastër nga "Leukoza enzootike" e gjedhit, siç përcaktohet në nenin 2 (2) (k) të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit nr.255, datë 10.6.2008 "Mbi problemet e shëndetit të kafshëve të llojeve gjedh dhe derra".

a) Testet që përdoren: AGID ose ELISA bllokuese, në përputhje me protokollet e përshkruar në manualin e OIE, versioni më i fundit.

b) Koha: kafshët do të testohen 2 herë: testimi i parë brenda 2 ditëve nga mbërritja në stacionin e karantinës dhe i dyti të paktën 42 ditë nga data e testimit të parë.

c) Mundësitë për veprim pas testimit: kafshët që rezultojnë pozitive pas testit të përshkruar në pikën (a) hiqen nga grupi i kafshëve në mjedisin e karantinës dhe kafshët e tjera do të ritestohen duke filluar të paktën 21 ditë pas datë, kur u krye testimi i parë pozitiv: kjo do të konsiderohet si testimi i parë i përshkruar në pikën (b).

Vetëm kafshët që rezultojnë negative në 2 teste të njëpasnjëshme të kryera sipas pikës (b) do të lejohen të hyjnë në Republikën e Shqipërisë.

ANEKSI II
MISHI I FRESKËT
PJESA I

(shtuar fjalë në kolonën e katërt për rreshtat "Serbi" dhe "Turqi" me udhëzimet nr. 125, datë 23.3.2018 dhe nr. 18, datë 11.1.2019; ndryshuar pika 2 me urdhirn nr. 327, datë 8.7.2022)

1. **Vendet e Bashkimit Europian**

Mund të importohet mish i freskët nga të gjitha ato vende që në çastin e importit janë anëtare të Bashkimit Europian kur ato shoqërohen nga modeli i certifikatës veterinare "BOV", "OVI", "POR", "EQU", "RUF", "RUW", "SUF", "SUW" dhe "EQW".

2. **Lista e vendeve jashtë Bashkimit Europian, territoreve dhe pjesëve të tyre ([1])**

Kodi ISO dhe emri i vendit eksportues	**Kodi i territorit**	**Përshkrimi i vendit eksportues, territorit ose pjesës së tij**	**Certifikata veterinare**		**Kushte të veçanta**	**Data e mbylljes**	**Data e hapjes ([3])**
			Modeli	**G SH**			
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**
MK – Maqedonia e Veriut	MK-0	I gjithë vendi	BOV, OVI, POR, EQU, RUF, RUW, SUF, SUW				
RS – Serbi	RS-0	I gjithë vendi	BOV, OVI, POR, EQU, RUF, RUW, SUF, SUW				

PJESA 2
MODELET E CERTIFIKATËS VETERINARE
(shfuqizuar me urdhrin nr.223, datë 25.6.2012)

ANEKSI III
Modeli i transitit/ ruajtjes

ANEKSI IV
Kafshët e përmendura në nenin 1(1)(b)

PJESA 1
Lista e vendeve, territoreve ose pjesëve të tyre

Seksioni 1
Pjesë e vendeve ose territoreve të përmendura në nenin 6(2)

Vendi/territori	**Kodi i pjesës së vendit/territorit**	**Përshkrimi i pjesës së vendit/territorit**
US – Shtetet e Bashkuara të Amerikës	US-A	Shteti i Havait (Hawaii) ([1])
([1]) I pezulluar që nga data 5 maj 2010		

PJESA 2
TABELAT E KAFSHËVE DHE MODELET PËRKATËSE TË CERTIFIKATAVE VETERINARE

Tabela 1

"QUE":	Model i certifikatës veterinare për ngarkesat e mbretëreshave të bletëve dhe të mbretëreshave të bombuseve (*Apis mellifera* dhe *Bombus* spp.)	
"BEE":	Model i certifikatës veterinare për ngarkesat e kolonive të bombuseve (*Bombus* spp.)	
Rendi: *Hymenoptera*	Familja: *Apidae*	Gjinia/ lloji: *Apis mellifera, Bombus spp.*

Modeli QUE

Çertifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë të mëmave të bletëve dhe bombuseve (Apis mellifera & Bombus spp.)

Model of veterinary certificate for consignments of queen bees and queen bumble bees (*Apis mellifera and Bombus* spp.)

Part I : Details of consignment / Pjesa I : Detajet e dorezimit

I.1. Consignor
Dërguesi

Name
Emri

Address
Adresa

Postal code/ Region
Kodi postar / Rajoni

Country
Shteti

Tel No.
Nr. Tel.

I.2. Certificate reference num
Numri i references se çertifikates

I.2a.

I.3.Central competent Authority
Autoriteti Kompetent Qendror

I.4. Local Competent Authority
Autoriteti Kompetent Vendor

I.5. Consignee
Marrësi

Name
Emri

Address
Adresa

Postal code / Region
Kodi postar/ Rajoni

Country
Shteti

Tel No.
Nr. Tel.

I.6

I.7.Country of origin
Shteti i origjines

ISO code
kodi ISO

I.8. Region of origin, Code
Rajoni i origjines, Kodi

I.9. Country of destination
Shteti i destinacionit

ISO code
Kodi ISO

I.10. Region of destination
Rajoni i destinacionit

I.11. Place of origin
Vendi i origjines

Name
Emri

Address
Adresa

I.12. Place of destination
Vendi i destinacionit

Place of loading
Vendi i ngarkeses

Address
Adresa

Approval number
Numri i Miratimit

I.14. Date of departure
Data e nisjes

I.15. Means of transport
Mjeti i transportit

Aeroplane ☐
Aeroplan

Ship ☐
Anije

Railway wagon ☐
Hekurudhe

Road vehicle ☐
Automjet

Other ☐
Tjeter

Identification :
Identifikimi

Document :
Dokument

I.16.Entry BIP in Albania
PIK e hyrjes ne Shqiperi

Name / Emri

BIP unit no.:
PIK nr.

I.17.

I.18. Description of commodity
Pershkrimi i mallit

I.19. Commodity code (HS code)
Kodi i mallit (kodi HS)

I.20. Quantity
Sasia

I.21.

I.22. Number of packages
Numri i pakove

I.23. Identification of container/Seal number
Identifikimi i kontenierit /numri i vulës

I.24.

I.25. Commodity certified as :
Mall i çertifikuar si:

Breeding ☐
Per mbareshtim

I.26.

I.27.

Definitive import ☐
Importi perfundimtar

I.28. Identification of the commodity
Identifikimi i mallit

Species (scientific name)
Llojet (emri shkencor)

Identification system
Sistemi i Identifikimit

Identification Number
Numri i Identifikimit

Modeli QUE ***Çertifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë të mëmave të bletëve dhe bombuseve (Apis mellifera & Bombus spp.)***

Model of veterinary certificate for consignments of queen bees and queen bumble bees (*Apis mellifera and Bombus* spp.)

Part II : Certification / Pjesa II : Çertifikata

II. **Health information** Informacion shendetesor	**II.a. Certificate reference number** Numri i referencës i çertifikatës	II.b.

II.1. Animal Health attestation:
Vërtetim për shëndetin e kafshëve

I, the undersigned official veterinarian, hereby certify, that the animals described in this certificate:
Unë, i nënshkruari Veterineri Zyrtar, me anë të kësaj vërtetoj që kafshët e përshkruara në këtë çertifikatë:

II.2.1. they come from the territory with code: ..... ([1]) in which, American foulbrood, the small hive beetle (*Aethina tumida*) and the Tropilaelaps mite (*Tropilaelaps spp.*) are notifiable diseases/pests.
vijnë nga territori me kodin : .....([1]) në të cilin, pesta amerikane, aetinoza (*Aethina tumida*) dhe paraziti Tropilaelaps (*Tropilaelaps spp.*) janë sëmundje/dëmtues të lajmërueshme.

II.2.1. they
ato

(a) comes from a breeding apiary, which is supervised and controlled by the competent authority;
vijnë nga një zgjua mbarështimi, që mbikqyret dhe kontrollohet nga autoriteti kompetent;

(b) comes from an area which is not subject to any restrictions associated with an occurrence of American foulbrood, and were no such occurrence has taken place within at least 30 days prior to the issuance of the present certificate. Where an outbreak of American foulbrood has occurred previously, all hives within a radius of three kilometres have been checked by the competent authority and all infected hives burned or treated and inspected to the satisfaction of the said competent authority within 30 days following the last recorded case;
vijnë nga një zonë që nuk i është nënshtruar ndonjë kufizimi në lidhje me pestën amerikane, dhe ku nuk ka patur shfaqje të sëmundjes të paktën 30 ditë para lëshimit të kësaj çertifikate. Kur më parë ka patur një shpërthim të pestës amerikane, të gjitha kosheret brenda një rrezeje prej tre kilometrash janë kontrolluar nga autoriteti kompetent dhe të gjitha kosheret e infektuara janë djegur ose janë trajtuar dhe inspektuar për përmbushjen e kërkesave të autoritetit kompetent në fjalë, brenda 30 ditëve pas rastit të fundit të regjistruar;

(c) are from hives or come from hives or colonies (in the case of bumble bees) from which samples of the comb have been tested in the last 30 days for American foulbrood as laid down in the OIE Manual of Diagnostic Tests and Vaccines for Terrestrial Animals with negative results;
janë nga koshere ose vijnë nga koshere ose nga koloni (në rastin e bombuseve), nga të cilat mostra nga kornizat e hojeve janë testuar në 30 ditët e fundit për pestën amerikane, siç përcaktohet në Manualin e OIE për Testet diagnostike dhe Vaksinat për Kafshët e Tokës, dhe kanë rezultuar negative;

(d) comes from an area at least 100 km radius which is not subject to any restrictions associated with an occurrence of the small hive beetle (*Aethina tumida*) or Tropilaelaps spp., and where these infestations are absent;
vijnë nga një zonë me rreze të paktën 100 km, që nuk i nënshtrohet ndonjë kufizimi në lidhje me aetinozën (*Aethina tumida*) ose *Tropilaelaps spp.*, dhe ku mungon infestimi me këta parazitë;

(e) are from hives or come from hives or colonies (in the case of bumble bees), which were inspected immediately prior to dispatch and show no clinical sings or suspicion of disease including infestations affecting bees;
janë nga koshere ose vijnë nga koshere ose nga koloni (në rastin e bombuseve), të cilat u inspektuan menjëherë para dërgimit dhe nuk shfaqën shenja klinike ose dyshimin për sëmundje, përfshi dhe infestime të bletëve.

(f) have undergone detailed examinations to ensure that all bees and packaging do not contain the small hive beetle (*Aethina tumida*) or their eggs and larvae, or other infestatios, in particular *Tropilaelaps spp.*, affecting bees.
i janë nënshtruar ekzaminimeve të hollësishme për të siguruar që të gjitha bletët dhe kontenierët ku mbahen nuk përmbajnë shkaktarin e aetinozës (*Aethina tumida*) apo vezë dhe larva të tyre, ose infestime të tjera që prekin bletët, veçanërisht *Tropilaelaps spp.*

II.1.3. the packaging material, queen cages, accompanying products and food are new and have not been in contact with diseased bees or brood-combs, and all precautions have been taken to prevent contamination with agents causing diseases or infestations of bees.
materialet e paketimit, kafazët e mëmave, produktet shoqëruese dhe ushqimi janë të reja dhe nuk kanë qenë në kontakt me bletë ose me hoje me pjellë të sëmura, dhe janë marrë të gjitha masat për të parandaluar kontaminimin me agjentë që shkaktojnë sëmundje ose infestime të bletëve.

Notes / Shënime

Part I / Pjesa I:

Box I.20: Number of queen bees (*Apis mellifera* and *Bombus spp.*). Each queen bee may accompanied by a maximum of 20 attendants.
Kutia I.20: Numri i mëmave (*Apis mellifera* dhe *Bombus spp.*). Çdo bletë mëmë mund të shoqërohet nga një maksimum prej 20 shoqëruesesh.

Part II / Pjesa II:

([1]) **Code of the territory as it appears in Part I of Annex II or Section 1 of Part I of Annex IV to Regulation (EU) No 206/2010.**
Kodi i territorit siç paraqitet në Pjesën I të Aneksit II ose në Seksionin 1 të Pjesës I të Aneksit IV të Rregullores (BE) Nr 206/2010.

Official veterinarian /official inspector
Veterineri zyrtar / inspektori zyrtar

Name (in Capital letters):
Emri (me germa Kapitale)

- Qualification and title:
- Kualifikimi dhe titulli

Date:
Data

Signature:
Firma :

Stamp
Vula

Modeli BEE ***Çertifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë***

të bombuseve (Bombus spp.)

Model of veterinary certificate for consignments of colonies of bumble bees

(*Bombus* spp.)

Part I : Details of consignment / Pjesa I : Të dhënat e ngarkesës

I.1. Consignor
Derguesi

Name
Emri

Address
Adresa

Postal code/ Region
Kodi postar / Rajoni

Country
Shteti

Tel No.
Nr. Tel.

I.2. Certificate reference num
Numri i referencës së çertifikatës

I.2a.

I.3.Central competent Authority
Autoriteti Kompetent Qendror

I.4. Local Competent Authority
Autoriteti Kompetent Vendor

I.5. Consignee
Marrësi

Name
Emri

Address
Adresa

Postal code / Region
Kodi postar/ Rajoni

Country
Shteti

Tel No.
Nr. Tel.

I.6

I.7.Country of origin
Shteti i origjines

ISO code
kodi ISO

I.8. Region of origin, Code
Rajoni i origjines, Kodi

I.9. Country of destination
Shteti i destinacionit

ISO code
Kodi ISO

I.10. Region of destination
Rajoni i destinacionit

I.11. Place of origin
Vendi i origjines

Name
Emri

Address
Adresa

I.12. Place of destination
Vendi i destinacionit

Place of loading
Vendi i ngarkesës

Address
Adresa

Approval number
Numri i Miratimit

I.14. Date of departure
Data e nisjes

I.15. Means of transport
Mjeti i transportit

Aeroplane ☐
Aeroplan

Ship ☐
Anije

Railway wagon ☐
Hekurudhe

Road vehicle ☐
Automjet

Other ☐
Tjeter

Identification :
Identifikimi

Document :
Dokument

I.16.Entry BIP in Albania
PKK e hyrjes në Shqipëri

Name / Emri

BIP unit no.:
PKK nr.

I.17.

I.18. Description of commodity
Përshkrimi i mallit

I.19. Commodity code (HS code)
Kodi i mallit (kodi HS)

I.20. Quantity
Sasia

I.21.

I.22. Number of packages
Numri i pakove

I.23. Identification of container/Seal number
Identifikimi i kontenierit /numri i vulës

I.24.

I.25. Commodity certified as :
Malli i çertifikuar si:

Breeding ☐
Për mbarështim

I.26.

I.27.

Definitive import ☐
Importi përfundimtar

I.28. Identification of the commodity
Identifikimi i mallit

Species (scientific name)
Llojet (emri shkencor)

Identification system
Sistemi i Identifikimit

Identification Number
Numri i Identifikimit

Modeli BEE ***Çertifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë të bombuseve (Bombus spp.)***

Model of veterinary certificate for consignments of colonies of bumble bees (*Bombus* spp.)

Part II : Certification / Pjesa II : Çertifikata

II. **Health information** Informacion shendetsor	**II.a. Certificate reference number** Çertifikate me numer reference	II.b.

II.1. Animal Health attestation:
Vërtetim për shëndetin e kafshëve

I, the undersigned, hereby certify that:
Unë, i nënshkruari, me anë të kësaj vërtetoj që:

II.1.1.

(a) The bumble bees (*Bombus spp.)* referred in Part I of this certificate have been bred and kept under a controlled environment within a recognized establishment which is supervised and controlled by the competent authority.
Bombuset (*Bombus spp.)* të përmendura në Pjesën I të kësaj çertifikate janë mbarështuar dhe mbajtur në një mjedis të kontrolluar brenda një stabilimenti të njohur, që mbikqyret dhe kontrollohet nga autoriteti kompetent.

(b) the establishment referred in Part I of this certificate was inspected immediately prior to dispatch and all bumble bees and breeding stock show no clinical sings or suspicion of disease including infestations affecting bees;
stabilimenti i përmendur në Pjesën I të kësaj çertifikate u inspektua menjëherë para dërgimit dhe të gjitha bombuset dhe larvat e tyre nuk shfaqën shenja klinike ose dyshimin për sëmundje, përfshi dhe infestime të bletëve.

(c) All colonies for import into Albania have undergone detailed examinations to ensure that all bumble bees, broodstock and packaging do not contain the small hive beetle (*Aethina tumida*) or their eggs and larvae or other infestatios, in particular *Tropilaelaps spp.*, affecting bees.
Të gjitha kolonitë për import në Shqipëri i janë nënshtruar ekzaminimeve të hollësishme për të siguruar që të gjitha bombuset, larvat e tyre dhe paketimi nuk përmbajnë shkaktarin e aetinozës (*Aethina tumida*) apo vezë dhe larva të tyre, ose infestime të tjera që prekin bletët, veçanërisht *Tropilaelaps spp.*.

II.1.2. the packaging material, containers, accompanying products and food are new and have not been in contact with diseased bees or brood-combs, and all precautions have been taken to prevent contamination with agents causing diseases or infestations of bees.
Materialet e paketimit, konteinerët, produktet shoqëruese dhe ushqimi janë të reja dhe nuk kanë qenë në kontakt me bletë ose me hoje me pjellë të sëmura, dhe janë marrë të gjitha masat për të parandaluar kontaminimin me agjentë që shkaktojnë sëmundje ose infestime të bletëve.

Notes
Shënime

Part I/ Pjesa I:

Box reference I.20: Number of containers of bumble bees (*Bombus spp.)*. Each containing a colony of a maximum of 200 adults bumble bees.
Kutia e referencës I.20: Numri i kontenierëve të bombuseve (*Bombus spp.)*. Secili përmban një koloni me një maksimum prej 200 bombuse të rritura.

Official veterinarian /official inspector
Veterineri zyrtar / inspektori zyrtar

Name (in Capital letters):
Emri (me gërma kapitale)

Qualification and title:
Kualifikimi dhe titulli

Date:
Data

Signature:
Firma :

Stamp
Vula

ANEKSI IV

Kafshët e përmendura në Nenin 1(1)(b)

PJESA 1

Lista e vendeve, territoreve ose pjesëve të tyre

Seksioni 1

Pjesë e vendeve ose territoreve të përmendura në Nenin 6(2)

Vendi/territori	**Kodi i pjesës së vendit/territorit**	**Përshkrimi i pjesës së vendit/ territorit**
US – Shtetet e Bashkuara të Amerikës	US-A	Shteti i Havait (Hawaii) ([1])
([1]) I pezulluar që nga data 5 maj 2010		

PJESA 2

Tabelat e kafshëve dhe modelet përkatëse të çertifikatave veterinare

Tabela 1

"QUE":	Model i çertifikatës veterinare për ngarkesat e mbretëreshave të bletëve dhe të mbretëreshave të bombuseve (*Apis mellifera* dhe *Bombus* spp.)	
"BEE":	Model i çertifikatës veterinare për ngarkesat e kolonive të bombuseve (*Bombus* spp.)	
Rendi: *Hymenoptera*	Familja: *Apidae*	Gjinia/ lloji: *Apis mellifera, Bombus spp.*

ANEKSI V
SHËNIME SHPJEGUESE PËR PLOTËSIMIN E CERTIFIKATAVE VETERINARE
(SIÇ PËRMENDET NË NENIN 16)

a) Certifikatat veterinare lëshohen nga vendi eksportues, mbështetur në modelet e përcaktuara në pjesën 2 të shtojcave I, II dhe IV dhe shtojcën III sipas formatit të modelit që u përgjigjet kafshëve të gjalla ose mishit të freskët përkatës/në fjalë.

Ato përmbajnë, në rend numerik që gjendet në model, vërtetimet që kërkohen për çdo vend dhe sipas rastit edhe ato garanci shtesë që kërkohen për vendin eksportues ose pjesë të tij.

Nëse kërkohen vërtetime për të certifikuar se janë plotësuar garancitë shtesë për kafshët e gjalla ose mishin e freskët në fjalë ato gjithashtu duhen përfshirë në formën origjinale të certifikatës veterinare.

b) Kur modeli i certifikatës përmban disa deklarata që duhen plotësuar, deklaratat e tjera që nuk janë të rëndësishme mund të eleminohen dhe të nënshkruhen dhe vulosen nga veterineri përkatës, ose të fshihen plotësisht nga certifikata.

c) Një certifikatë e veçantë dhe unike duhet të sigurohet për kafshët e gjalla/ mishin e freskët që eksportohen nga një territor ose territore të të njëjtit vend eksportues të paraqitura në kollonat 2 dhe 3 të pjesës 1 të aneksit I, II ose IV që dërgohen në të njëjtin vend dhe transportohen në të njëjtin vagon treni, mjet transporti, avion ose anije.

d) Origjinali i çdo certifikate përbëhet nga një fletë e vetme letre, ose nëse nevojitet më shumë tekst ai duhet shkruar në një mënyrë të tillë që të gjitha fletët e letrës që nevojitet janë pjesë e një certifikate të plotë dhe të pandashme.

e) Certifikata veterinare e importit duhet të jetë e hartuar të paktën në gjuhën angleze, si dhe në gjuhën shqipe.

f) Nëse për arsye të identifikimit të artikujve të ngarkesës (të parashikuar në pikën I.28 të modelit të certifikatës veterinare), fletë të tjera shtesë i bashkëlidhen certifikatës, këto fletë duhet të konsiderohen si pjesë përbërëse e origjinalit të certifikatës, duke zbatuar nënshkrimin dhe vulën e veterinerit çertifikues në secilën prej faqeve.

g) Kur certifikata, përfshi dhe numrin e fletëve shtesë të përmendura në pikën (f), përfshin më shumë sesa 1 faqe, secila faqe duhet numërtuar (numri i faqes me numrin total të faqeve), në fund të secilës faqe dhe do të mbajë numrin e referencës së certifikatës që është përcaktuar nga autoriteti kompetent qendror në fillim të faqeve.

h) Certifikata origjinale duhet plotësuar dhe nënshkruar nga një veteriner zyrtar ose nga ndonjë inspektor zyrtar i përcaktuar, kur kjo është parashikuar në modelin e certifikatës veterinare. Në rastin e kafshëve të gjalla, certifikata duhet të plotësohet dhe nënshkruhet brenda 24 orëve përpara ngarkimit të ngarkesës për hyrje në Republikën e Shqipërisë.

i) Ngjyra e nënshkrimit duhet të jetë e ndryshme nga ajo e shtypjes. Kjo kërkesë zbatohet edhe për vulat që nuk janë vula të thata ose filigranë.

ii) Numri referencës i certifikatës që përmendet në kutitë I.2 dhe II.a duhet të lëshohet nga autoriteti kompetent vendor.